

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Politika e Jashtme e Kosovës

Nga 17 shkurti 2008 e deri më 17 shkurt 2009

Mars 2009

Tabela e Aktiviteteve Njëjeçare në Politikën e Jashtme

	Kosova	Serbia	Të tjerët
Shkurt	<ul style="list-style-type: none"> • Shpallja e Pavarësisë më 17 shkurt 2008 • 21 shtete e njohin Republikën e Kosovës (në mënyrë kronologjike): Kosta Rika, SHBA, Franca, Afganistani, Shqipëria, Turqia, Britania e Madhe, Australia, Senegali, Gjermania, Letonia, Danimarka, Estonia, Italia, Luksemburgu, Peru, Belgjika, Polonia, Zvicra, Austria, Irlanda. • Serbia dhe Kosova përfaqësohen në mënyrë të barabartë në mbledhjen e Paktit të Stabilitetit në Sofje. 	<ul style="list-style-type: none"> • Serbia tërheq ambasadorët e saj nga shtetet që pranojnë Kosovën • Digjen në Beograd ambasadat e vendeve të huaja që kanë njohur shtetin e Kosovës; • Serbia paralajmëron se do të bëjë kërkesë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) që të kërkojë ligshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës 	<ul style="list-style-type: none"> • Takohet Këshilli i Sigurimit me kërkesë të Serbisë dhe Ruisë për të diskutuar shkëljen e Rezolutës 1244, pas shpalljes së pavarësisë; • Rumunia mbyll zyrën e saj ndërlidhëse në Prishtinë; • Misioni i BE tërhiqet nga Mitrovica Veriore; • Gjermania mbyll shërbimin konsullor në Beograd dhe të njëjtën kohë e transformon zyrën ndërlidhëse në Prishtinë në nivel të ambasadës,
Mars	<ul style="list-style-type: none"> • 14 shtete të reja e njohin Kosovën: Suedia, Holanda, Islanda, sllovenia, Finlanda, Japonia, Kanadaja, Monako, Hungaria, Kroacia, Bullgaria, Lihtenshtajni, Koreja Jugore dhe Norvegjia. 		<ul style="list-style-type: none"> • Takimi i Këshillit të Ministrave të BE-së për Kosovën, Spanja kërkon që UNMIK-u të administrojë veriun e Kosovës; • Presidenti i SHBA-ve autorizon furnizimin e Kosovës me pajisje ushtarake për nevojat e FSK-së; • Shefi i NATO-s viziton Kosovën; • Në samitin e Konferencës së Vendeve Islamike, Turqia kërkon njohjen e Kosovës; • Me kërkesë të Serbisë, Këshilli i Sigurimit i OKB-së mban seancë;

Prill	<ul style="list-style-type: none"> • 3 shtete njohin Republikën e Kosovës: Ishujt Marshall, Nauru, Burkina Faso. 	<ul style="list-style-type: none"> • Zyra Ndërlidhëse e SHBA shndërrohet në ambasadë; • Kryeministri Thaçi merr pjesë në mbledhjen e KS-së të OKB-së për Kosovën; 	
Maj	<ul style="list-style-type: none"> • 4 shtete të reja njohin Kosovën: Lituania, San Marino, Republika Çeke dhe Liberia. • Në Samitin e Procesit për Bashkëpunim në Evropën Juglindore (SEECP), ministri Hyseni mban fjalim, duke shkaktuar reagim tek presidenti serb Tadiq, i cili në shenjë proteste largohet nga samiti; • Në Vjenë, ministri Hyseni takon ambasadorë nga Amerika Qendrore dhe Jugore (Peru, Kosta Rika, Panama, Paraguai); • Flamuri i Kosovës u ngrit për herë të parë në ndërtesën e Parlamentit Evropian në takimin e parë ndër-parlamentar në mes PE-së dhe Kuvendit të Kosovës ; 	<ul style="list-style-type: none"> • Serbia nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit; 	<ul style="list-style-type: none"> • Në Samitin e liderëve të Evropës Qendrore dhe Juglindore në Ohër diskutohet për Kosovën, pa Kosovën. • Kina, India dhe Rusia kërkojnë negociata të reja për statusin e Kosovës;
Qershor	<ul style="list-style-type: none"> • Sierra Leone njeh shtetin e pavarur të Kosovës dhe ngrit në 43 numrin e njohjeve; • Hyn në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe hynë në fuqi mbi 40 ligje nga pakoja e Ahtisarit, ndër to edhe dy ligje 	<ul style="list-style-type: none"> • Jeremiç në Organizatën e Shteteve të Amerikës kërkon mos njohjen e pavarësisë së Kosovës; 	<ul style="list-style-type: none"> • Ban ki-Moon i dërgon letër Sejdiut dhe Tadiçit duke i informuar për reformimin e administratës ndërkombëtare të OKB, që më vonë do të njihet si plani 6 pikësh; • Mbahet mbledhja e KS-së ku mirëpritet plani i Ban ki-Moon për rikonfigurimin e UNMIK-ut, në gjashtë pika kryesore;

	<ul style="list-style-type: none"> nga fusha e punëve të jashtme; • Sejdiu i jep ultimatum UNMIK-ut deri në vjeshtë që të largohet nga Kosova; • Presidenti Sejdiu merr pjesë në mbledhjen e KS-së dhe përkrah rikonfigurimin e UNMIK-ut në bazë të planit gjashtë pikësh; 	<ul style="list-style-type: none"> • Sekretari i OKB paralajmëron hapjen e bisedimeve për çështjet teknike në mes të Serbisë dhe Kosovës;
Korrik	<ul style="list-style-type: none"> • Ministri Hyseni merr pjesë në seancën e Këshillit të Sigurimit ku diskutohet për Kosovën; • Presidenti dhe Kryeministri i Kosovës takohen në SHBA me Presidentin Bush, Sekretarin e Mbrojtjes dhe Sekretaren e Jashtme; • Kosova aplikon për anëtarësim në FMN dhe Bankën Botërore; • Një grup i përfaqësuesve të shoqërisë civile në Kosovë marrin një iniciativë për lobim; • Në Kuvendin e Kosovës kryeministri Thaçi akuzohet se nuk janë pranuar 100 njohje, ashtu siç pati deklaruar, kurse Thaçi përgjigjet se Kosovën do ta njohin 193 shtete, e jo 100. 	<ul style="list-style-type: none"> • Jeremiç kërkon mbështetje nga Blloku i Shteteve të Painkuadruara; • Në Aman të Jordanisë, me organizim të shoqërisë civile, mbahet konferenca “Kosova dhe bota arabe”, ku nga Kosova marrin pjesë një delegacion i shoqërisë civile i formuar për lobim; • Mbahet konferenca e donatorëve për Kosovën; • KS i OKB-së mban takim për Kosovën ku administratori i UNMIK-ut Zannier raporton për procesin e bisedimeve për rikonfigurimin e UNMIK-ut.
Gusht	<ul style="list-style-type: none"> • 3 shtete njohin pavarësinë e Kosovës: Kolumbia, Belize dhe Malta. 	<ul style="list-style-type: none"> • Jeremiç viziton OKB-në në Nju Jork ku prezanton draft rezolutën e GJND-së;

- Sejdiu dhe Hyseni marrin pjesë në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së;
- Sejdiu kërkon nga vendet Arabe që ta njohin Kosovën;
- Kryeministri Thaçi deklaron se Kosova është e orientuar kah perëndimi dhe se nuk do të lidhet me qendra të dyshimta, duke u kundërpërgjigjur ndaj konferencës së mbajtur në Prishtinë me temën “Kosova dhe bota arabe”, deklaratë e cila shkaktoi reagim nga disa intelektual arab që morën pjesë në këtë konferencë;
- Kosova emëron 10 të ngarkuar me punë në këto shtete: ShBA, Britani e Madhe, Francë, Gjermani, Itali, Turqi, Shqipëri, Austri, Zvicër dhe Belgjikë;

Shtator

- Samoa njih pavarësinë e Kosovës;
- Ministri Hyseni takohet me Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Konferencës Islamike;
- Sejdiu dhe Hyseni mbajnë takime të shkurtra në Nju Jork më përfaqësues të vendeve të ndryshme;
- Jeremiç lobon në disa vende për të kërkuar mbështetjen për kërkesën për GJND (Athinë, Berlin);
- Presidenti i Shqipërisë Bamir Topi i adresohet Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së dhe kërkon njohjen e Kosovës;
- Komisionari për zgjerim Oli Rehn deklaron se anëtarësimi i Serbisë në BE nuk varet nga statusi i Kosovës;

	<ul style="list-style-type: none"> • Pas takimit me përfaqësuesit e Malajzisë dhe Egjiptit Hyseni kërkon që të njohin shtetin e Kosovës; 		
Tetor	<ul style="list-style-type: none"> • 5 shtete njohin Kosovën: Portugalia, Mali i Zi, Maqedonia, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Malajzia; 	<ul style="list-style-type: none"> • Asambleja e përgjithshme e OKB-së aprovon kërkesën serbe për dhënien e mendimit juridik për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës; kërkesa kalon me 77 vota pro, 6 kundër dhe 74 abstenime; • Sekretari i Mbrojtjes i SHBA-së Robert Gates viziton Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë; 	
Nëntor	<ul style="list-style-type: none"> • Sejdiu, Thaçi dhe Hyseni vizitojnë Britaninë e Madhe ku takohen me kryeministrin Brown dhe ministrin e Punëve të Jashtme Miliband; • Hyseni takon Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Konferencës Islamike; • Hyseni kërkon njohje nga vendet e CARICOM-it (Bashkësisë së Shteteve të Karaibeve); • Skender Hyseni merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit në të cilën mirëpritet plani i Ban Ki-Moon, i cili përfshin planin 6 pikësh dhe 4 pikat e propozuara nga Prishtina; 	<ul style="list-style-type: none"> • Jeremiç adreson në mbledhjen e KS-së dhe përshëndet qëndrimin e KS-së ndaj planit të Ban Ki-Moon, duke e konsideruar si fitore të Serbisë; 	<ul style="list-style-type: none"> • David Miliband viziton Kosovën dhe i adresohet Kuvendit të Kosovës; • Daniel Fried viziton Kosovën ku diskutohet për planin 6 pikësh;

Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • Mikronezia njih shtetin e Kosovës; 	<ul style="list-style-type: none"> • Jeremiç deklarohet se nëse integrimi i Serbisë në BE kushtëzohet me heqjen dorë nga Kosova, Serbia heq dorë nga BE-ja; 	<ul style="list-style-type: none"> • Misioni i BE-së, EULEX shtrihet në tërë Kosovën; • Turqia sërish deklaron se do të vazhdoj lobimin për të sjellë njohje të reja për Kosovën; • George Bush merr vendim që Kosovës t'i bëhen lehtësime tregtare me SHBA-në;
Janar 2009	<ul style="list-style-type: none"> • Panamaja njih shtetin e Kosovës; • Ministri Hyseni deklaron se edhe gjatë vitit 2009 politika e jashtme e Kosovës nuk do të ndryshoj strategjinë; • Ministri Hyseni pret njohje të reja për Kosovën nga një varg shtetesh një pjesë e mirë e të cilave do të realizohet më 17 shkurt; 	<ul style="list-style-type: none"> • Jeremiç takohet me Ban Ki-Moon dhe kërkon mbështetjen e 80 shteteve; • Jeremiç deklaron se ka informata se po bëhet presion tek 50 shtete të ndryshme që të njohin Kosovën; 	<ul style="list-style-type: none"> • Presidenti i Shqipërisë viziton Kosovën dhe premtun nënshkrimin e një marrëveshje “mini shengen” për qarkullimin e lirë të njerëzve Shqipëri - Kosovë; • Ministri i Punëve të Jashtme i Turqisë viziton Kosovën dhe nënshkruhet një marrëveshje Turqi-Kosovë për heqjen e vizave; • Ministri i Jashtëm britanik i dërgon letër 30 shteteve për njohjen e Kosovës;
Shkurt 2009	<ul style="list-style-type: none"> • Kremtohet një vjetori i shtetit të Kosovës; • Republika e Maldiveve njih edhe zyrtarisht shtetin e Kosovës duke ngritur numrin e njohjeve në 55; • Presidenti Sejdiu dekreton tetë misione të reja diplomatike dhe nëntë misione konsullore të Republikës së Kosovës; 		<ul style="list-style-type: none"> • Me ftesë të Departamentit të Shtetit, krerët shtetëror të Kosovës vizitojnë SHBA-të për tu takuar me Sekretaren e Jashtme Hillary Clinton.

Përmbajtja:

I. Hyrje	9
II. Baza ligjore	9
III. Zbatimi i Legjislacionit në fuqi	11
IV. Procesi i njohjeve	12
V. Kosova vis-a-vis institucioneve ndërkombëtare	13
VI. Politika e jashtme bilaterale	15
VII. Kosova vis-a-vis iniciativave të Serbisë	16
VIII. Përfundim	19
IX. Aneks 1:	21
Bashkëngjitja Institucioneve Ndërkombëtare Financiare (publikuar në shkurt 2008) ..	21
X. Aneks 2: Këshilli i Evropës (publikuar në prill 2008)	25
XI. Aneks 3: Kosova në marrëdhëniet ndërkombëtare (publikuar në mars 2008)	35

I. Hyrje

Kosova, pas afro tetë viteve të administrimit ndërkombëtar nga OKB-ja, pas negociatave gati dyvjeçare për zgjidhjen e statusit final, në përputhje me propozimin e ndërmjetësit të OKB-së Marti Ahtisarit, më 17 shkurt 2008 shpalli pavarësinë e saj. Kosova, përmes Deklaratës së Pavarësisë, u zotua se do të zbatojë "Pakon e Ahtisarit" në tërësi, dhe se si shtet i pavarur do të hyjë në marrëdhënie ndërkombëtare, do të lidh marrëveshje ndërkombëtare, do të kërkojë anëtarësim në organizmat ndërkombëtarë dhe do të marrë përsipër përgjegjësitë nga marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale që janë lidhur nga UNMIK-u në emër të Kosovës.

Pas më shumë se një vit që nga shpallja e pavarësisë, sa ka arritur Kosova që të përmbush zotimet e dhëna në Deklaratën e Pavarësisë sa i përket fushës së marrëdhënieve të jashtme? A ka plotësuar Kosova kushtet e nevojshme për të hyrë në marrëdhënie ndërkombëtare? Sa marrëveshje ndërkombëtare ka nënshkruar? Në sa organizma ndërkombëtare ka kërkuar anëtarësim? A i ka marrë përgjegjësitë nga marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale që janë nënshkruar nga UNMIK-u në emër të Kosovës?

Për të dhënë përgjigje në këto pyetje, Instituti për Studime të Avancuara GAP ka hartuar këtë dokument mbi bazën e hulumtimeve dhe mbledhjes së informacionit për periudhën një vjeçare të Kosovës si shtet, duke pasqyruar aktivitetet kryesore të Kosovës në këtë fushë gjatë një viti. Analiza e Institutit GAP do të përqendrohet në analizimin e bazës ligjore të brendshme që ka të bëjë me politikën e jashtme të Kosovës, nivelin e zbatimit të kësaj baze ligjore, procesin e njohjeve, si dhe në aktivitetet e Kosovës në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Sa i përket kësaj fushe, Instituti për Studime të Avancuara GAP ka publikuar edhe tri analiza të tjera që kanë të bëjnë me anëtarësimin e Kosovës në organizmat ndërkombëtarë dhe marrjen e përgjegjësisë në marrëveshjet ndërkombëtare, si; "Bashkëngjitja Institucioneve Financiare Ndërkombëtare - Rruga Përpara", "Këshilli i Evropës - kushtet dhe procedurat për anëtarësim", dhe "Kosova në Marrëdhëniet Ndërkombëtare", të cilat janë të bashkangjitura në këtë punim si anekse.

II. Baza ligjore

Për nëntë vite radhazi Kosova ka qenë e qeverisur nga Misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK) nën dokumentin më të lartë ligjor *Rezolutën 1244 të KS-së të OKB-së të 10 qershorit 1999*. Gjatë kësaj periudhe, në fushën e marrëdhënieve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, UNMIK-u kishte kompetenca të plota dhe në të gjitha marrëveshjet e nënshkruara Kosova përfaqësohej përmes UNMIK-ut, marrëveshje në të cilat fatkeqësisht ende Kosova nuk ka mundur të përfaqësohet si shtet i pavarur.¹

¹ Për marrëveshjet ndërkombëtare të Kosovës deri më 17 shkurt 2008 shih edhe publikimin e Institutit për Studime të Avancuara GAP me titull "Kosova në Marrëdhëniet Ndërkombëtare" (<http://www.institutigap.org/repository/docs/shqip4.pdf>).

Pas negociatave mbi një vjeçare në mes të Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësim të bashkësisë ndërkombëtare, ku Kosova ishte e përfaqësuar nga "Ekipi i Unitetit", ndërmjetësuesi i OKB-së në bisedime Marti Ahtisari hartoi *Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës ("Pako e Ahtisarit")* sipas të cilit Kosova fitonte pavarësinë e mbikëqyrur, me kompetenca të plota në politikën e brendshme dhe të jashtme të saj: "Kosova do të gëzojë të drejtën e negocimit dhe lidhjes së marrëveshjeve ndërkombëtare dhe të drejtën për të kërkuar anëtarësim në organizata ndërkombëtare."²

Më 17 shkurt 2008, Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë e Kosovës, duke u zotuar se do të zbatojë "Pakon e Ahtisarit" në tërësi dhe se si shtet i pavarur do të hyjë në marrëdhënie ndërkombëtare, do të lidh marrëveshje ndërkombëtare, do të kërkojë anëtarësim në organizmat ndërkombëtarë dhe do të marrë përsipër përgjegjësitë që ka nga marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale që janë lidhur nga UNMIK-u në emër të Kosovës.³ Duke u mbështetur në Pakon e Ahtisarit, edhe Kushtetuta e Kosovës përshkruan kompetencat e shtetit të pavarur të Kosovës në fushën e marrëdhënieve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare.⁴

Më 15 qershor 2008 hyjnë në fuqi një mori ligjesh që parashiheshin me Pakon e Ahtisarit dhe ishin miratuar me procedurë të përspejtuar gjatë muajve shkurt-qershor 2008. Gjatë kësaj periudhe u miratuan edhe këto ligje, që vënë bazat e funksionimit të politikës së jashtme të Kosovës: Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shërbimin diplomatik të Republikës së Kosovës; Ligji për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ushtarake si dhe personelin e saj; Ligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës; Ligji për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës (dy ligjet e fundit janë miratuar në Kuvend në dhjetor 2008).

Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shërbimin diplomatik të Republikës së Kosovës vë kornizat e funksionimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ). Sipas këtij ligji, MPJ formulon dhe zbaton politikën e jashtme të Kosovës (neni 3.2). Me këtë ligj përcaktohen edhe kompetencat e Presidentit, Kryeministrit dhe Komisionit për Punë të Jashtme⁵, sidomos në rolin që kanë këto institucione në përzgjedhjen e shërbyesve diplomatikë. Me këtë ligj parashihet që punonjësit në ambasadat e Kosovës të rekrutohen në bazë të konkursit, ashtu siç përzgjidhen të gjithë shërbyesit e tjerë civil, dhe në përzgjedhjen e tyre duhet që të ekzistojë një bashkërendim në mes të Presidentit, Kryeministrit dhe Kuvendit të Kosovës. Ligji parasheh nxjerrjen e tetë akteve nënligjore dhe publikimin e tyre në ueb faqen zyrtare të MPJ-së⁶, mirëpo këto akte nënligjore ende nuk janë nxjerrë, duke bërë që ky ligj të mbetet ende i pa kompletuar.

² Neni 1.5, Dispozitat e Përgjithshme të Dokumentit Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

³ Pika 8 dhe 9 e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, 17 shkurt 2008.

⁴ Neni 17, 18 dhe 19 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

⁵ Nw nenin 7.2 të këtij ligji, Komisioni për Politikë të Jashtme i Kuvendit të Kosovës shënohet gabimisht si Komisioni për Marrëdhënie Ndërkombëtare, e në fakt nuk ekziston një komision me emërtim të tillë në Kuvendin e Kosovës.

⁶ Neni 11 i Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe shërbimin diplomatik të Republikës së Kosovës.

Ligji për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ushtarake si dhe personelin e saj. Ky ligj rregullon statusin e misioneve dhe ekspertëve të misioneve të huaja që veprojnë në Kosovë. Në këtë kategori hyjnë misionet diplomatike të vendeve të huaja, ekspertët në mision të OKB-së dhe agjencive të saja të specializuara, personeli i OSBE-së, etj. Gjithashtu, në këtë ligj caktohen edhe rastet kur një person në këto misione mund të klasifikohet si “persona non grata”.

Ligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës rregullon veprimtarinë e shërbimit të jashtëm, organizimin, bashkërendimin dhe funksionimin e organeve që përbëjnë shërbimin e jashtëm dhe rregullimin e statusit të personelit diplomatik.⁷ Sipas këtij ligji, misionet e Republikës së Kosovës jashtë vendit janë misione diplomatike dhe misione konsullore, dhe ky ligj përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre misioneve, gjithnjë duke u bazuar në Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike (1961) dhe Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Konsullore (1963). Gjithashtu, ky ligj përcakton gradat diplomatike në shërbimin e jashtëm (siç janë: ambasador, ministër, ministër këshilltar, këshilltar, sekretar i parë, sekretar i dytë, sekretar i tretë dhe atashe); dhe gradat konsullore (konsull i përgjithshëm, konsull, zëvendëskonsull dhe agjent konsullor). Me këtë ligj parashihet edhe nxjerrja e Rregullores për Shërbimin e Jashtëm, formimin e Komisionit të Gradave dhe Disiplinës dhe nxjerrja e shumë akteve nënligjore të cilat do të duhej që të hartoheshin brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Ligji për shërbimin konsullor të misioneve diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës është ligj i cili përcakton bazat e funksionimit dhe detyrat e misioneve konsullore të Kosovës, gjithnjë duke u bazuar në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore, përcakton mënyrën e përzgjedhjes së personelit në misionet konsullore, format e ndihmës që mund t'i ofrohen shtetasve të Kosovës që veprojnë në rrethin ku është e akredituar konsullata e Kosovës, etj. Më qëllim të konkretizimit më praktik të këtij ligji, në afat prej tre muajsh nga hyrja e këtij ligji në fuqi parashihet nxjerrja e akteve nënligjore dhe Rregullores për Shërbimin Konsullor. Ky ligj ka hyrë në fuqi në dhjetor 2008.

III. Zbatimi i Legjislacionit në fuqi

Ministria e Punëve të Jashtme zyrtarisht ka filluar punën më 16 qershor 2008, kur ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Ministrinë e Punëve të Jashtme. Sipas organogramit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, kjo ministri parashihet që të ketë 80 punonjës. Deri më tani janë punësuar vetëm pak më shumë se gjysma apo 45 veta (staf politik dhe administrativ).⁸

Në mesin e muajit tetor 2008 kanë filluar punën dhjetë ambasada të Republikës së Kosovës në këto vende: Uashington, Bruksel, Londër, Berlin, Bernë, Tiranë, Paris, Romë, Vjenë dhe Ankara. Presidenti i Republikës së Kosovës ka emëruar dhjetë të ngarkuar me

⁷ Neni 1 i Ligjit për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës.

⁸ MPJ ka hapur një konkurs për pranimin edhe të 28 punonjësve të rinjë, konkurs i cili është i hapur deri më 9 mars 2009.

punë që do të udhëheqin këto ambasada. Me 10 shkurt 2009 presidenti i Republikës ka dekretuar edhe tetë ambasada të reja dhe dhjetë misione konsullore. Ambasadat e reja do të hapen në këto vende: Slloveni, Kroaci, Holandë, Suedi, Republika Çeke, Hungari, Bullgari dhe Japoni; kurse konsullatat e para do të hapen në: SHBA, Britani të Madhe, Francë, Gjermani, Itali, Zvicër, Austri, Belgjikë dhe Suedi. Më 13 shkurt 2009, MPJ ka shpallur konkurs për rekrutimin e 18 ambasadorëve të Republikës së Kosovës, konkurs i cili është i hapur deri më 13 mars. Në konkurs janë hedhur edhe pozitat e të ngarkuarve me punë në dhjetë ambasadat e gjertanishme të Kosovës, si dhe tetë ambasada të reja.

Edhe pse vërehet një përparim i dukshëm sa i përket vënies së bazës së brendshme ligjore për politikën e jashtme, si dhe në marrjen e të drejtave dhe obligimeve që përcaktohen me Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike (1961) dhe Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Konsullore (1963), ende mbetet punë për t'u bërë në hartimin e akteve dytësore legjislative. Ministria e Punëve të Jashtme është përgjegjëse për nxjerrjen e akteve nënligjore, mirëpo deri më tani kanë nxjerrë vetëm një akt nënligjor dhe, sipas tyre, janë në proces të hartimit të tyre.

Gjithashtu, MPJ duhet që brenda periudhës tre mujore nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit për Shërbimin e Jashtëm dhe Ligjit për Shërbimin Konsullor dhe misionet diplomatike e konsullore, të hartojë dy rregulloret tejet të rëndësishme: Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm dhe Rregulloren për Shërbimin Konsullor. Vonesat eventuale në hartimin e Rregullores për Shërbimin e Jashtëm do të vononin edhe formimin e Komisionit për Grada dhe Disiplinë, i cili po ashtu është një institucion kyç në kompletimin e infrastrukturës ligjore dhe institucionale në politikën e jashtme të Kosovës. Ligji për shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi në janar 2009, parasheh themelimin e Akademisë Diplomatike e cila do të duhej që të merrej me trajnimin e diplomatëve, por kjo Akademi ende nuk është funksionalizuar. Sipas këtij ligji, misionet e Republikës së Kosovës jashtë vendit janë: misione diplomatike dhe misione konsullore.

IV. Procesi i njohjeve

Deri më tani Kosova është njohur nga 55 shtete. Nga këto shtete, një pjesë e madhe janë anëtare të Bashkimit Evropian. Secili shtet anëtar i BE-së vendos vetë nëse do të njohë pavarësinë e ndonjë vendi pasi që BE-ja nuk ka ndonjë mjet ligjor që këtë ta bëjë për tërë anëtarët e vet në mënyrë diplomatike. Shumica e shteteve që kanë njohur Kosovën kanë vendosur marrëdhënie diplomatike me shtetin më të ri duke i forcuar lidhjet e tyre përmes hapjes së zyrave ndërlidhëse si dhe të ambasadave të këtyre shteteve në Kosovë.

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, në shkurt 2008, 21 shtete njohën Republikën e Kosovës duke përfshirë SHBA-në, Britaninë e Madhe dhe shumicën e shteteve anëtare të Bashkimit Evropian. Kosovarët vazhdojnë që të mbajnë lidhje të forta me këto shtete që gjithashtu edhe prej tyre të kërkohet që të përdorin ndikimin e tyre si super fuqi për njohjen sa më shpejtë të Kosovës nga shtetet që ende nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Gjatë marsit 2008, 14 shtete të reja njohin Kosovën duke e ngritur numrin e njohjeve në 35 vetëm gjatë 2 muajve të parë pas shpalljes së pavarësisë. Ky proces njohjesh vazhdon

edhe gjatë muajve të ardhshëm por me një intensitet më të ngadalësuar, ku deri në tetor 2008 gjithsej 52 shtete njohin Kosovën. Gjatë këtij muaji edhe dy nga fqinjët e Kosovës, Maqedonia dhe Mali i Zi, njohin pavarësinë e Kosovës, duke mbetur vetëm Serbia si një ndër kundërshtarët kryesorë të pavarësisë së Kosovës.

Republika e Kosovës është njohur nga:

- 28% shtete anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) (55/192)
- 81% e shteteve të BE-së, (22/27)
- mbi 84% e shteteve anëtare të NATO-s, (22/26)
- 70% të shteteve të Këshillit të Evropës, (33/47)
- 60% të shteteve anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së; (3/5).

V. Kosova vis-a-vis institucioneve ndërkombëtare

Qasja edhe anëtarësimi në institucionet dhe organizatat ndërkombëtare vazhdon të jetë pjesa më problematike e shtet-ndërtimit dhe arritjeve të politikës së jashtme të Kosovës. Nga shumë organizata ndërkombëtare ekzistuese, Kosova ka aplikuar vetëm në Fondin Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankën Botërore. Pas përmbushjes së kushteve për të aplikuar në këta dy organizma më të rëndësishëm ndërkombëtar, Kosova zyrtarisht aplikoi më 10 korrik 2008.⁹ Që nga ajo kohë, FMN ka filluar procedurën zyrtare të anëtarësimit. Në bazë të kushteve për anëtarësim në FMN dhe BB, Kosova ka siguruar shumicën e votave për anëtarësim dhe tani pret kryerjen e procedurave formale deri tek anëtarësimi i plotë.

Përveç në FMN dhe BB, Kosova nuk ka aplikuar në asnjë organizëm tjetër ndërkombëtar për anëtarësim. Në shumë organizma ndërkombëtar, të tipit ekonomik, politik, juridik, sportiv, etj., anëtarësimi i Kosovës është i kushtëzuar edhe nga anëtarësimi në OKB. Liderët kosovarë kanë adresuar katër herë gjatë vitit 2008 në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit të OKB-së në rastet kur është diskutuar për Kosovën. Kosova nuk ka marrë asnjë hap konkret në drejtim të kërimit që të aplikojë në Këshillin e Evropës.¹⁰

Aktualisht Kosova sa i përket marrëdhënieve me Bashkimin Evropian ka statusin e vendit potencial për anëtarësim dhe Kosovën e kanë njohur 22 nga 27 shtetet anëtare të BE-së. BE është e përfaqësuar në disa mënyra në Kosovë, si përmes Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, Përfaqësuesit Special të BE-së, etj. Nga ana e BE-së, Kosova është e mbuluar nga Instrumenti i Ndihmës për Para-anëtarësim (IPA), si dhe mbahen takime të rregullta të Kosovës dhe BE-së përmes Mekanizmit Përcjellës të Procesit të Stabilizim Asociimit (STM). STM është instrumenti kryesor për dialogun

⁹ Më 19 shkurt 2008 Instituti për Studime të Avancuara GAP ka publikuar analizën ekonomike me “Bashkëngjitja Institucioneve Financiare Ndërkombëtare – Rruga Përpara”. Në këtë analizë Instituti GAP ka përshkruar kushtet dhe procedurat për aplikim në FMN dhe BB, duke kërkuar nga Qeveria e Kosovës që sa më parë të aplikojë në këto dy organizma. Këtë publikim mund ta lexoni në: http://www.gapinstitute.org/repository/docs/Analize_Anetaresimi_ne_FMN_dhe_BB.pdf

¹⁰ Në prill 2008, Instituti GAP ka prezantuar para Komisionit për Integritet Evropian dokumentin me titull “Këshilli i Evropës – kushtet dhe procedurat për aplikim”.

politik në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian. Në fillim të shkurtit 2009, Parlamenti Evropian me shumicë votash ka miratuar një Rezolutë e cila u bënë thirrje vendeve anëtare të BE-së që të mbështesin pavarësinë e Kosovës. Që disa vite radhazi Komisioni Evropian publikon Raportin e progresit për Kosovën, kurse në vitin e ardhshëm është paralajmëruar edhe publikimi i studimit të fizibilitetit për Kosovën. Një nga objektivat e Kosovës në planin afatshkurtër është edhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit në afat maksimal prej pesë vitesh.

Objektiv tjetër i MPJ-së është edhe tentimi për t'u bërë pjesë e Iniciativës së Partneritetit për Paqe të NATO-s në një periudhë pesë vjeçare, si dhe anëtarësimi i Kosovës në OSBE. Serbia në seancat e OSBE-së ka deklaruar se do të bllokojë çdo tentativë të Kosovës për t'u anëtarësuar në këtë organizëm, apo në çdo organ ndërkombëtar ku vendimet merren me konsensus.

Kosova nuk ka arritur që të vendos marrëdhënie më të ngushta pune me Organizatën e Konferencës Islamike. Përveç disa takimeve që ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës ka pasur me Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës së Konferencës Islamike, nuk është shënuar ndonjë hap konkret sa i përket marrëdhënieve konkrete në mes të Kosovës dhe këtij organizmi ndërkombëtar 57 anëtarësh.

Sa i përket kontakteve me Unionin Afrikan, Kosova nuk ka arritur që të shënojë ndonjë sukses në marrëdhëniet me këtë organizëm 53 anëtarësh. Serbia, e cila ka statusin e vëzhguesit në Unionin Afrikan, ka shfrytëzuar kontaktet dhe statusin e vendit vëzhgues që të kërkojë mos njohjen e shtetit të Kosovës nga vendet e këtij Unioni. Në samitin e 11 të Unionit Afrikan të mbajtur në Sharm El Sheikh më 30 qershor 2008, adresoi edhe presidenti i Serbisë Boris Tadiq i cili në fjalimin e tij kërkoi mos njohjen e "shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës", duke u përkujtuar vendeve afrikane se rasti i Kosovës mund të shërbejë si precedan edhe për rajone të tjera të botës.

Edhe pse ka kaluar më shumë se një vit që nga shpallja e pavarësisë, Kosova edhe më tutje vazhdon që të përfaqësohet si UNMIK/Kosova në marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara në emër të Kosovës nga ana e UNMIK-ut. Kosova nuk ka treguar vendosmëri në marrjen e kompetencave në këtë fushë. Si pasojë e kësaj, pas ndërrimit të vulave të doganave nga Doganat e UNMIK-ut në Doganat e Kosovës, Serbia dhe Bosnja kanë bllokuar mallrat e Kosovës, duke bërë që të mos respektohet marrëveshja e CEFTA-s për tregti të lirë, anëtare e së cilës është edhe Kosova. Edhe pas iniciativave të Kosovës për zhbllokimin apo përdorimin e masës së reciprocitetit asgjë nuk është ndërmarrë tash 3 muaj prej se Serbia dhe Bosnja i bllokojnë produktet kosovare. (shih aneksin 2 - Marrëveshjet Ndërkombëtare).

Përveç që nuk është shënuar ndonjë sukses në sigurimin e mbështetjes nga organizmat e rëndësishëm ndërkombëtarë, as federatat e ndryshme sportive në Kosovë nuk kanë arritur sukses në anëtarësimin e tyre në federatat ndërkombëtare. Gjatë vitit 2008 vetëm Federata e Peshëngritjes është pranuar si anëtare e plotë në Federatën Ndërkombëtare të Peshëngritjes, si dhe me të drejta të kufizuara është pranuar edhe Federata e Mundjes në Federatën Ndërkombëtare të kësaj kategorie. Përfaqësues të Federatës së Futbollit të Kosovës kanë mbajtur takime të drejtpërdrejta me përfaqësuesit e UEFA-s, por pa

ndonjë sukses për anëtarësim, ngase një nga arsyetimet e UEFA-s është se Kosova nuk mund të bëhet pjesë e këtij organizmi pasi që nuk është anëtare e OKB-së. Në historikun e gjertanishëm të kësaj organizate, ka pasur dhe ka shtete që janë anëtare të UEFA-s dhe FIFA-s, por nuk janë anëtare të OKB (për shembull, edhe para se të anëtarësohej në OKB Zvicra ishte anëtare e UEFA-s dhe FIFA-s). Nuk është shënuar asnjë sukses as në anëtarësimin e Federatës së Basketbollit të Kosovës në FIBA. Para 17 shkurtit 2008, tri federata të Kosovës kishin arritur që të anëtarësoheshin në organizmat ndërkombëtarë, Federata e Shahut, Ping Pongut dhe Hendbollit. Në fushën e turizmit, Kosova ka arritur të anëtarësohet vetëm në Shoqatën Amerikane të Turizmit (ATS). Kosova nuk ka arritur një prefiks të veçantë për telefoninë e saj dhe as të anëtarësohet në organizatën ndërkombëtare të përcaktimit të domenëve (ICAAAN).

Marrëveshjet që janë nënshkruar në emër të Kosovës para 17 shkurtit 2008, Kosova ende vazhdon të përfaqësohet në to në emër të UNMIK-ut, pasi që në të gjitha këto marrëveshje është anëtare edhe Serbia, e cila kundërshton përfaqësimin e Kosovës si Republika e Kosovës.

VI. Politika e jashtme bilaterale

Deklarimi kryesor zyrtar i shtetit të Kosovës në politikat e jashtme është integrimi veriatlantik, mirëpo përbrenda këtij synimi nuk ka vizion konkret për arritjen e saj. Për më tepër iniciativat për marrëdhënie më të mira bilaterale mbasin iniciativa të shteteve tjera e jo iniciativa që burojnë nga Kosovarët.

Para shpalljes së pavarësisë, Kosova (apo UNMIK/Kosova) kishte arritur disa marrëveshje bilaterale, kryesisht me Shqipërinë, Turqinë, SHBA-në, Bankën e Investimeve Evropiane (EIB) dhe Bankën Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim (EBRD), etj. Edhe pas shpalljes së pavarësisë, marrëdhëniet më të mira bilaterale kanë vazhduar të jenë me Shqipërinë, Turqinë dhe SHBA-të.

Shqipëria, përveç njohjes, mbështetjes diplomatike dhe lobimeve në organizatat e ndryshme për njohjen e Kosovës, ka premtuar edhe ndihmë konkrete për shtetin e Kosovës. Shqipëria ka premtuar krijimin e një "mini shengeni ballkanik" ku qytetarët kosovarë do të kenë të drejtë që të udhëtojnë në Shqipëri pa pasaporta. Edhe më tutje vazhdojnë marrëveshjet bilaterale me Shqipërinë, si: marrëveshja për mënjanimin e tarifave të dyfishta; për promovimin reciprok dhe mbrojtjen e investimeve, në fushën e energjisë, etj.

Edhe me Turqinë Kosova mban ende marrëveshjet e nënshkruara para shpalljes së pavarësisë, si dhe disa marrëveshje të reja dhe ndihma konkrete të shtetit Turk për Kosovën. Gjatë vizitës në Janar të Ministrit të Jashtëm Turk bërë Kosovës janë nënshkruar dy marrëveshje: për udhëtimin e Kosovarëve pa viza në Turqi, si dhe Dokumenti Strategjik i Bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Turqisë. Në Dokumentin Strategjik të Bashkëpunimit parashihen marrëdhënie më të përafërta në mes të dy vendeve, përpjekje të përbashkëta për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, ndihmë në ngritjen e kapaciteteve të MPJ-së të Kosovës, etj.

SHBA, përveç mbështetjes diplomatike për pavarësinë e Kosovës, ka dhënë edhe ndihmë konkrete për shtetin e Kosovës. Dy administratat e fundit amerikane, ajo republikane dhe demokrate, kanë ftuar përfaqësuesit e Kosovës për vizitë në SHBA ku janë pritur në nivelet më të larta shtetërore. Administrata Amerikane ka ndërmarrë një iniciativë që Kosovës t'i krijojë lehtësira tatimore në rast se Kosova eksporton në SHBA, si dhe ofrimi i ndihmës në mjete ushtarake për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kosova ka arritur të vë marrëdhënie të mira bilaterale edhe me Britaninë e Madhe, me ç'rast janë shënuar vizita të nivelit të lartë të Kosovës në Britaninë e Madhe, dhe anasjelltas. Me shtetet që kanë pranuar Kosovën, marrëdhëniet bilaterale kanë mbetur vetëm në vënien e marrëdhënieve diplomatike, por pa ndonjë hap konkret për marrëdhënie më të afërta. Nga 55 shtete që e kanë njohur Kosovën, rreth 20 shtete kanë hapur ambasadat e tyre në Prishtinë, kurse një numër i vogël i shteteve që nuk e kanë njohur Kosovën kanë të hapura në Prishtinë zyrat ndërlidhëse. Kosova ka hapur ambasadat e saj në dhjetë vende.

Shumica e takimeve të ministrit të MPJ-së të Kosovës kanë qenë kryesisht takime në nivel ambasadorësh në vende të treta, kryesisht takime në Vjenë dhe Nju Jork. Vizitat e ministrit të MPJ kryesisht kanë qenë në Vjenë, Bruksel, Nju Jork.

VII. Kosova vis-a-vis iniciativave të Serbisë

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008 Serbia nisi menjëherë ofensivën e saj për anulimin e "shpalljes së njëanshme" të pavarësisë së Kosovës. Serbia kishte deklaruar se ka përgatitur një plan veprimi si kundërpërgjigje nëse Kuvendi i Kosovës shpall pavarësinë e vendit. Një nga masat e Serbisë që proklamohej ishte edhe bllokada ekonomike ndaj Kosovës. Ky kërcënim i Serbisë nuk u vë në jetë asnjëherë, mirëpo menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, turmat e revoltuara serbe dogjën pikat doganore 1 dhe 31 në veri të Kosovës, duke bërë që për një kohë të gjatë të mos kishte kontroll doganor në këto pika.

Serbia gjithashtu u dërgoi nota proteste të gjitha vendeve që njohën pavarësinë e Kosovës, si dhe tërhoqi ambasadorët e vet nga vendet që e njohën Kosovën. Në Beograd pati protesta masive dhe demolim të ambasadave të huaja, me ç'rast shumë përfaqësi diplomatike dhe konsullore u tërhoqën përkohësisht nga Beogradi. Pas aprovimit të kërkesës nga OKB për të kërkuar mendim nga GJND, Serbia ashpërsoi politikën ndaj shteteve që njohin Kosovën pas kësaj date. Sipas deklaratës së vetë ministrit Jeremiq, Serbia do t'i shpallte "persona non grata" të gjithë ambasadorët e vendeve që e njohin Kosovën pas kësaj date.

Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, Serbia pati paralajmëruar se do të bëjë kërkesë në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, që të kërkojë ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, gjë të cilën edhe e realizoi. Në tetor 2008 Asambleja e përgjithshme e OKB-së aprovoi kërkesën serbe për dhënien e mendimit juridik për ligjshmërinë e shpalljes. Kjo kërkesë kaloi më 77 vota pro, 6 kundër dhe 74 abstenime.

Datë	Aktivitete e Serbisë përballë pavarësisë së Kosovës
17 shkurt	Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës Serbia kërkon mbledhje urgjente të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Këshillit të përhershëm të OSBE-së dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës. Jeremiç deklaroi se për sa kohë që Serbia është anëtare e OKB-së, OSBE-së dhe Këshillit të Evropës, do të bllokojë anëtarësimin e Kosovës në këta organizma.
20 shkurt	Serbia i dërgon notë proteste Letonisë dhe Senegalit.
20 shkurt	Serbia i dërgon notë proteste Francës, Kosta Rikës, Britanisë së Madhe, Australisë, Shqipërisë, si dhe tërheq ambasadorët nga këto shtete.
21 shkurt	Serbia i dërgon notë proteste Italisë dhe Estonisë.
	Serbia i tërheq vëmendjen Slllovenisë se në rast të pranimit të Kosovës do të prishen marrëdhëniet ekonomike në mes të dy vendeve.
	Serbia i dërgon notë proteste Gjermanisë, Luksemburgut dhe Danimarkës.
26 shkurt	Jeremiç deklaroi se Serbia do të përqendrohet në atë që Kosova të ketë sa më pak njohje.
	Jeremiç deklaroi se Serbia dhe Rusia do të hartojnë një plan unik për kundërshtimin e pavarësisë së Kosovës.
28 shkurt	Jeremiç deklaroi se Serbia nuk do të pengojë punën e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, përderisa Kosova vazhdon të përfaqësohet si UNMIK/Kosova.
29 shkurt	Jeremiç i dërgon letër Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së si shenjë proteste për formimin e Grupit Drejtues Ndërkombëtar
29 shkurt	Serbia i dërgon notë proteste Austrisë për shkak se kjo e fundit e njohu Kosovën
4 mars	Serbia i dërgon notë proteste Suedisë dhe Holandës për shkak se këto shtete e njohën Kosovën
5 mars	Serbia i dërgon notë proteste Slllovenisë për shkak se kjo e fundit e njohu Kosovën
6 mars	Serbia i dërgon notë proteste Islandës për shkak se kjo e fundit e njohu Kosovën
7 mars	Serbia i dërgon notë proteste Finlandës për shkak se kjo e fundit e njohu Kosovën.
18 mars	Serbia i dërgon notë proteste Monakos për shkak se kjo e fundit e njohu Kosovën
19 mars	Serbia i dërgon notë proteste Kroacisë për shkak se kjo e fundit e njohu Kosovën
20 Mars	Serbia i dërgon letër udhëheqësve të të gjitha organizatave ndërkombëtare me të cilën i njofton për kundërshtimin e Serbisë ndaj deklarimit të njëanshëm të pavarësisë së Kosovës dhe kërkon mos njohjen e Kosovës.
24 mars	Gjatë vizitës së tij në Vietnam, Jeremiç kundërshtoi pavarësinë e Kosovës
2 prill	Qeveria e Serbisë proteston ndaj Shkupit zyrtar për shkak të fillimit të shënimit të vijës së demarkacionit me autoritetet Kosovare.
24 prill	Serbia i dërgon notë proteste Burkina Fasos për shkak se kjo e fundit e njohu Kosovën
maj	Serbia nënshkruan Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me BE-në.
2-3 maj	Presidenti serb Tadiq merr pjesë në samitin e Shefave të Shteteve të Evropës Qendrore dhe kërkon anulimin e pavarësisë së Kosovës dhe ndërprerjen e njohjeve.
7 maj	Jeremiç merr pjesë në Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës dhe kërkon nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës që të mos e njohin pavarësinë e Kosovës
7 maj	Serbia i dërgon notë proteste Lituanisë për shkak se kjo e fundit e njohu Kosovën
11 maj	Serbia mban zgjedhjet e saja lokale në territorin e Kosovës.
21 maj	Tadiq lëshon samitin e Procesit të Bashkëpunimit të Vendeve të Evropës Juglindore

	(SEECIP) në Bullgari në shenjë proteste të pjesëmarrjes së Ministrit të Jashtëm të Kosovës Skënder Hyseni; si dhe i dërgon notë proteste Ban Ki Moon për të kërkuar dënimin e përgjegjësve të UNMIK-ut që kanë lejuar Hysenin të përfaqësojë Kosovën.
28 maj	Kryetari i parlamentit serb Oliver Duliq kundërshton pjesëmarrjen e Kosovës në debatin e organizuar nga Parlamenti Evropian për të diskutuar për Ballkanin Perëndimor; Serbia dërgon notë proteste në parlamentin Evropian pasi që Kosova ka marrë pjesë si vend i pavarur në këtë takim.
2 qershor	Jeremiq adreson në Organizatën e Shteteve Amerikane në Bogota dhe kërkon nga shtetet anëtare të kësaj organizate që të mos e njohin pavarësinë e Kosovës dhe të mbështesin rezolutën e Serbisë për ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë.
9 qershor	Oda e Ekonomisë dhe Industrisë së Serbisë deklaroi se ka arritur të bllokojë anëtarësimin e Odës Ekonomike të Kosovës në “Eurochambers” (Odat Ekonomike Evropiane) në Bruksel.
17 qershor	Serbia i dërgon notë proteste Liberisë dhe Sierra Leones për shkak të njohjes së Kosovës
30 qershor	Jeremiq dhe Tadiq marrin pjesë në samitin e Unionit Afrikan , ku në adresimin e tij Tadiq kërkon mos njohjen e shtetit të Kosovës.
24 korrik	Serbia vendos që të kthejë ambasadorët e saj në vendet anëtare të BE-së.
25 korrik	Jeremiq adreson në mbledhjen e Këshillit të Sigurimit për Kosovën.
30 korrik	Jeremiq kërkon nga vendet anëtare të “Lëvizjes së të Painkuadruarve” që të mbështesin kërkesën e Serbisë për kërkimin e opinionit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës.
8 shtator	Jeremiq merr pjesë në Konferencën e Ministrave të vendeve të Ligës Arabe dhe kërkon nga 22 shtete anëtare të kësaj Lige që të mbështesin kërkesën e Serbisë për opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.
9 tetor	Serbia shpall “persona non grata” ambasadorët e Malit të Zi dhe Maqedonisë në Beograd
18 tetor	Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miraton kërkesën e Serbisë që pavarësia e Kosovës të shqyrtohet nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
2 nëntor	Serbia shpall “persona non grata” ambasadorin e Malajzisë në Beograd , pasi që ky shtet njohu Kosovën.
1 dhjetor	Tadiq kërkon rishikimin e Marrëveshjes së Kumanovës
9 janar 2009	Jeremiq shpall tri prioritetet e Serbisë për vitin 2009: mbrojtja e rendit kushtetues, përshtetimi i procesit të integritetit në BE dhe përmirësimi i bashkëpunimit regjional, duke mos përmendur Kosovën si prioritet.
Janar 2009	Jeremiq takohet me Ban Ki-Moon dhe kërkon mbështetjen e 80 shteteve.

Përderisa Kosova është duke bërë përpjekje që të arrijë marrëveshje dy palëshe në sektorë të ndryshëm me shtete të ndryshme, gjë e cila është konsideruar nga shumë ekspertë si çështje e rëndësishme për GJND-në, Beogradi në anën tjetër është duke bërë përpjekje duke kërkuar mbështetjen e 80 shteteve që t'i drejtohen Gjykatës Ndërkombëtare duke shprehur pozitën zyrtare të vendit të tyre sa i përket shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës më së largu deri më 17 prill të këtij viti.

Çështje kontestuese mbetet edhe Plani Gjashtë Pikësh i Sekretarit të OKB për Kosovën. Këshilli i Sigurimit në mbledhjen e mbajtur në nëntor të vitit 2008 mirëpriti Planin 6

pikësh, ku në dokumentin final përfshihen gjashtë pikat që ishin arritur në bashkëpunim me Beogradin, si dhe katër pikat që kishte propozuar Prishtina. Që nga kjo mbledhje, Serbia vazhdimisht kërkon zbatimin e Planit gjashtë pikësh në veri të Kosovës.

Serbia vazhdimisht ka kërcënuar shtetet që do të njohin Kosovën me prishje të marrëdhënieve diplomatike. Ministri i Jashtëm serb Jeremiq ka adresuar në të gjitha organizmat ndërkombëtar dhe ka kërkuar mos njohjen e shtetit të Kosovës nga një sërë vendesh në këto organizata, si në: Konferencën Islamike, Samitin e Vendeve të Painkuadruara, organizmat e vendeve Afrikane dhe të Amerikës Latine, etj. Politika e Jashtme serbe është klasifikuar si e suksesshme në iniciativat e saj.¹¹

VIII. Përfundim

Pas një viti që nga shpallja e pavarësisë, Republika e Kosovës ka formuar Ministrinë e Punëve të Jashtme, ka zgjedhur ministrin, zëvendës ministrin si dhe dhjetë të emëruar me punë në dhjetë kryeqytetet më të mëdha botërore. Procesi i hapjes së ambasadave ka shkuar shumë ngadalë dhe ky proces ende nuk mund të quhet i përmbyllur. Tek në mesin e muajit shkurt, MPJ ka hapur konkursin e parë për përzgjedhjen e 18 ambasadorëve të rinj për 18 ambasadat e dekretuara nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Presidenti gjithashtu ka dekretuar edhe 10 konsullata të Kosovës jashtë vendit, por ende nuk është shpallur konkurs për përzgjedhje të konsujve dhe ende nuk ka as të ngarkuar me punë.

MPJ ka një bazë të mirë ligjore për të funksionuar, mirëpo ende nuk janë nxjerr aktet më të rëndësishme nënligjore, përfshirë edhe Rregulloren për Shërbimin e Jashtëm dhe Rregulloren për Shërbimin Konsullor. Në mungesë të këtyre rregulloreve dhe akteve nënligjore, nuk janë formuar ende edhe institucione të rëndësishme që do t'i asistojnë ministrisë e që parashihen me ligjet e politikës së jashtme, si: Komisioni për Grada dhe Disiplinë dhe Akademia Diplomatike. Deri më tani MPJ ka nxjerrë vetëm një akt nënligjor, apo Udhëzimin administrativ nr. 01/2009 për procedurat e aplikimit, intervistimit dhe ngushtimit të listës së kandidatëve për ambasadorë dhe shefa të tjerë të misioneve. Në ngritjen e kapaciteteve të MPJ-së kanë ndihmuar shtetet që kanë njohur Kosovën, si SHBA, Britania e Madhe, Turqia, Gjermania, Shqipëria, etj.

Gjatë periudhës një vjeçare që Kosova funksionon si shtet i pavarur është njohur nga 55 shtete. Ky numër i shteteve është larg asaj sa është proklamuar nga liderët e vendit para njohjes së pavarësisë, kur është deklaruar se Kosova do të njihet shumë shpejt nga 100 shtete. Kosova ka aplikuar vetëm në FMN dhe Bankën Botërore dhe nuk ka treguar asnjë aktivitet konkret në anëtarësimin e Kosovës në organizmat tjerë ndërkombëtarë. Edhe më tutje Kosova vazhdon që të përfaqësohet në marrëveshjet ndërkombëtare dhe regionale si UNMIK/Kosova.

Serbia ka ndërmarrë një fushatë të fortë lobimi në shtetet dhe organizma të ndryshme ndërkombëtare, duke kërkuar nga shtetet tjera që të mos njohin pavarësinë e Kosovës.

¹¹ http://www.economist.com/world/europe/displaystory.cfm?story_id=13110072

Për këtë, Serbia ka arritur që të kalojë një Rezolutë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB që të kërkojë mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës, duke bërë që disa shtete të presin mendimin e kësaj trupe, para se të marrin vendimin për njohje. Serbia gjithashtu nuk ka lëshuar asnjë mundësi që të adresojë në samitet e organizmave ndërkombëtare, si në Asamblenë e Përgjithshme, Unionin Afrikan, Vendet e Painkuadruara, Konferencën Islamike, etj.

Ndihmë të madhe në procesin e njohjeve që i kanë arritur Kosovës kanë dhënë shtetet si SHBA, Britania e Madhe, Turqia, të cilat kanë shfrytëzuar kontaktet dhe ndikimin e tyre dhe kanë kërkuar që të njihet Kosova. Shumica e shteteve që kanë njohur gjer tani Kosovën bien nën sferën e ndikimit amerikan dhe shteteve të tjera të fuqishme Evropiane.

ANEKSI 1

BASHKANGJITJA INSTITUCIONEVE NDËRKOMBËTARE FINANCIARE (botuar më 19 shkurt 2008)

Hyrje

Serbia dhe Rusia janë zotuar se në qoftë se Kosova e shpall pavarësinë, ato do të përpiqen që ta përjashtojnë Kosovën nga çdo forum ndërkombëtar ku ato mund ta bllokojnë, duke e kufizuar sovranitetin e saj. Plani i përfaqësuesit special të Kombeve të Bashkuara Marti Ahtisaari nuk kaloi në Këshillin e Sigurimit, për shkak të kundërshtimit nga anëtari me të drejtë vetoje rusia. Prandaj ka shumë pak gjasa Kosova të anëtarësohet në KB në periudhën afatshkurtër. Megjithatë, ka institucione, anëtarësia në të cilat është shumë e rëndësishme, dhe ku anëtarësia nuk mund të bllokohet nga një shtet.

Një ndër pikat kryesore të Planit të Ahtisarit për shtetësinë e Kosovës është mundësia që Kosova t'i bashkangjitet institucioneve ndërkombëtare financiare. Kjo do të thotë se Kosova është në gjendje t'i bashkangjitet dy institucioneve të rëndësishme të sistemit të Bretton Woods-it, Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) dhe Bankës Botërore (BB) Kjo analizë rekomandon hapat e ardhshëm që Kosova duhet t'i ndërmerret për tu bërë anëtare e familjes së madhe ndërkombëtare financiare. Autoritetet e Kosovës veçse kanë filluar diskutimet joformale me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Në të dyja Institucionet Ndërkombëtare Financiare (IFN) për të cilat flet kjo analizë, vendimet mirren nga Bordi Qeverisës që përbëhet nga shtetet anëtare, me fuqi të ndryshme votimi në përputhje me fuqinë e tyre ekonomike. Vendimet për të pranuar anëtarë të ri kërkojnë aprovimin e shumicës së thjeshtë nga Bordi Qeverisës (50 + 1 përqind). Disa nga pronarët më të mëdhenj të këtyre institucioneve janë Shtetet e Bashkuara dhe disa shtete Evropiane që e përkrahin pavarësinë e Kosovës. Fuqitë vendimmarrëse janë proporcionale me numrin e aksioneve që një shtet I ka. Mëposhtë mund të shihni përqindjet e fuqive votuese për shtetet më të fuqishme.

“Bordi i Guvernatorëve, trupi më i lartë vendimmarrës në FMN, përbëhet nga një guvernator dhe nga një zëvendës guvernator nga secili shtet anëtar. Guvernatori caktohet nga shteti anëtar dhe zakonisht është ministri i financave ose guvernatori i bankës qendrore. Të gjitha fuqitë e FMN-së janë të vendosura në Bordin e Guvernatorëve. Bordi i guvernatorëve mund të delegojë tek Bordi Ekzekutiv të gjitha përveç fuqive të rezervuara. Bordi i Guvernatorëve zakonisht takohet njëherë në vit.” (Burimi: FMN)

Informatat tjera mbi anëtarësinë dhe përparësitë e anëtarësimit

Një shteti anëtar në FMN i caktohet kuota, që është proporcionale me nivelin e ekonomisë së atij shteti si edhe potencialit që ajo ekonomi ka. Kuota e një anëtari në FMN përcakton:

- Shumën e parapagimit – Kosova duhet ta paguaj një shumë parapagimi në përputhshmëri me kuotën;
- Fuqinë votuese; kuota përcakton fuqinë votuese të një shteti (shih tabelën më poshtë)
- Qasjen në financim tek FMN; huamarrja nga këto institucione është e kufizuar;
- Alokimin e të Drejtave Speciale të Tërheqjes (SDR's) që përdoret si njësi matëse nga FMN dhe paraqet një shportë të valutave kryesore botërore.

Për qëllime të krahasimit, kuota e malit të Zi është diku .01 përqind e totalit (27.5 milion SDR) dhe ka 525 vota apo .02 përqind të totalit. Kuota e Shqipërisë është .02 përqind (48.7 milion SDR) dhe ka 737 vota (.03 përqind e totalit). (*Burimi: FMN*)

Përveç financimit të kufizuar, beneficinet e anëtarësimit përfshijnë:

- Ndihmë në reformat strukturale me qëllim të zvogëlimit të varfërisë,
- Fonde për të arritur këto reforma strukturale,
- Informata të besueshme të cilat mund të ju shkojnë investitorëve për ekonominë dhe rrezikun e investimeve në Kosovë, që më fund do të çojë drejt rangimit kreditor të Kosovës;
- Ndihmë në politike drejt arritjes së stabilitetit makroekonomik dhe fiskal.

Më me rëndësi, në këtë periudhë, FMN dhe BB janë dy institucione të rëndësishme financiare, dhe anëtarësia në këto institucione përveç përparësive zhvillimore dhe financiare do të forconte legjitimitetin e Kosovës si shtet i pavarur.

Prandaj, në qoftë se një numër kritik i shteteve aksionare në FMN dhe BB mbështesin pranimin e anëtares së re, Kosova mund të bëhet anëtare e këtyre dy institucioneve prestigjioze. Megjithatë, procesi i anëtarësimit nuk është i lehtë dhe kërkon shumë punë nga shteti që aplikon për anëtarësim. Këtë e kemi parë nga eksperiencia e disa shteteve të reja në botë që janë bërë anëtarë së fundi në këto institucione siç janë Timori Lindor dhe Mali i Zi. Prandaj është shumë me rëndësi që qeveria e Kosovës të inicojë procesin e anëtarësimit në këto dy institucione posa ta shpall pavarësinë.

Borxhi potencial i jashtëm (gjysma e të cilit është ndaj Bankës Botërore) është diskutuar gjatë negociatave për status në Vienë. Autoritetet e Kosovës kanë shprehur gatishmërinë për të marrë borxhin që potencialisht i takon Kosovës, pas shqyrtimit të dokumentacionit origjinal të borxhit. Autoritetet serbe që momentalisht po e kthejnë atë borxh, nuk e kanë siguruar dokumentacionin origjinal në lidhje me borxhin e Kosovës ndaj Bankës Botërore. Kjo analizë nuk e ka për qëllim që të ofrojë informata në lidhje me borxhin e Kosovës ndaj Bankës Botërore. Poashtu nuk merr ndonjë pozicion në lidhje me çështjen. Qëllimi i kësaj analize është vetëdijësimi sa më i madh mbi anëtarësimin në IFN dhe për të dhënë informacione për hapat e parë në këtë procedurë.

PROCEDURA

Një shtet duhet të jetë anëtar i Fondit Monetar Ndërkombëtar para se të bëhet anëtar i Bankës Botërore. Edhe pse anëtarësimi në bankë Botërore, poashtu përfshin shumë punë procedurale, prioriteti i parë duhet të jetë fillimi i negociatave me FMN-në. Prandaj, shteti duhet të aplikojë në FMN para se të aplikojë në Bankë Botërore.

PARAKUSHTET

Anëtarësia në FMN është në të njëjtën kohë pjesa më e rëndësishme dhe pjesa më e vështirë e procesit të anëtarësimit. Për tu bërë anëtar i FMN-së, duhet të përmbushen këto kriterë:

- 1. Aplikuesi duhet të jetë shtet – FMN nuk kërkon si parakusht anëtarësimin në KB*
- 2. Aplikuesi duhet të jetë në kontroll të punëve të jashtme – Pas shpalljes së pavarësisë, autoritetet e Kosovës do të jenë në kontroll të punëve të jashtme.*
- 3. Aplikuesi duhet të ketë mundësinë dhe duhet të jetë gati ti marrë obligimet e anëtarësimit – Kjo përfshin ndryshimin në legjislacion të shtetit aplikues, ku Kosova do të ndërmirte obligimet e anëtarësimit. Aplikuesi duhet të kompletojë gjithë legjislacionin, që do ti lejonte Kosovën të nënshkruante artikujt e marrëveshjes me FMN-në. Kjo në mes tjerash do të përfshinte zotimin për të paguar anëtarësinë e caktuar, autorizimin e përfaqësuesit në këto institucione, p.sh. Ministrin e Financave.*

Aplikimi Formal dhe Kuota e Anëtarësimit

Pas përmbushjes së të gjitha këtyre kushteve, një shtet duhet të plotësojë aplikacionin për anëtarësim në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Pas pranimin të aplikimit, FMN dërgon mision special të anëtarësimit në Kosovë për të mbledhur informata dhe për të përgatitur një dokument vlerësues të ekonomisë së Kosovës. Misioni poashtu rekomandon edhe pjesëmarrjen e shtetit në FMN që bëhet sipas pozitës ekonomike të atij shtetit në krahasim me shtetet e tjera.

Misioni i anëtarësimit do të kërkojë nga autoritetet e Kosovës mbledhjen e informatave për ekonominë e Kosovës që nga viti 1984. Kjo do të paraqet vështirësi për autoritetet e Kosovës, pasi që informatat mbi ekonominë e Kosovës, posaçërisht gjatë viteve të 90 nuk janë të disponueshme shumë lehtë dhe do të kërkonin shumë supozime. Autoritetet e Kosovës dhe FMN duhet të jenë gati për të adresuar çështjen e informatave që nuk ekzistojnë.

Komisioni Ad-Hoc

Bordi Ekzekutiv i Fondit Monetar Ndërkombëtar cakton një komision Ad-Hoc, që përbëhet nga 6 – 8 drejtor ekzekutiv nga bordi që caktohen sipas rekomandimeve të drejtorit menaxhues. Ky komision është përgjegjës për aprovimin e kuotës si dhe

kushteve të tjera të anëtarësimit. Kryesuesi i këtij komisioni më vonë kontakton shtetin për të parë se a pajtohen me rekomandimet e komisionit.

Votimi

Në qoftë se ka pajtim, propozimi i dërgohet bordit të guvernatorëve për aprovim. Propozimi kërkon 51 përqind të votave, për të marrë aprovimin. Pas aprovimit, shtetet apolikuase kanë gjashtë muaj për të kompletuar legjislacionin. Procesi procedural i Bankës Botërore mund të bëhet në të njëjtën kohë, pasi që ka shumë procedura administrative që duhen të kompletohen.

Fuqia Votuese në FMN Sipas Kuotës

Shteti	Kuota/Fuqia Votuese
1 SHBA	17.09
2 Japonia	6.13
3 Gjermania	5.99
4 Mbretëria e Bashkuar	4.94
5 Franca	4.94
6 Kina	3.72
7 Italia	3.25
8 Arabia Saudite	3.21
9 Kanada	2.93
10 Federata Ruse	2.74
11 Holanda	2.38
12 Belgjika	2.12
13 India	1.91
14 Zvicra	1.59
15 Australia	1.49
16 Meksiko	1.45
17 Braziki	1.4
18 Spanja	1.4
19 Korea	1.35
20 Venecuela	1.22
21 Suedia	1.1
Total 21 shtete	72.35
Të tjerat	27.65

*FMN vebsajt

Fuqia Votuese në BB (IBRD)

Shteti	Kuota/fuqia Votuese
1 SHBA	16.38
2 Japonia	7.86
3 Gjermania	4.49
4 Mbretëria e Bashkuar	4.3
5 Franca	4.3
6 Kina	2.78
7 Italia	2.78
8 Arabia Saudite	2.78
9 Kanada	2.78
10 Federata Ruse	2.78
11 India	2.78
12 Holanda	2.21
13 Brazili	2.07
14 Belgjika	1.81
15 Spanja	1.74
16 Zvicra	1.66
17 Australia	1.53
18 Irani	1.48
19 Korea	1.35
20 Venecuela	1.27
21 Meksiko	1.18
Total 21 shtete	70.31
Të tjerat	29.69

*BB vebsajt

ANEKSI 2

Këshilli i Evropës (botuar në vitin 2008)

HYRJE

Këshilli i Evropës është organizatë ndërkombëtare e shteteve evropiane e themeluar më 5 maj 1949 dhe njihet si organizata më e vjetër politike evropiane. Në fillim të funksionimit të Këshillit të Evropës (KE) ishin 11 shtete nënshkruese të statutit të KE¹², kurse tani KE ka 47 vende anëtare¹³ dhe shteti i fundit i anëtarësuar në KE është Mali i Zi, i anëtarësuar më 11 maj 2007. KE u themelua duke pasur për qëllim arritjen e bashkëpunimit më të madh të shteteve evropiane dhe ngritjen e besimit midis shteteve e popujve, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, promovimin e demokracisë parlamentare dhe shtetit ligjor, promovimin e standardeve të larta për politikën sociale dhe ligjore, si dhe nxitjen e ndërgjegjësimit për një identitet të përbashkët evropian. Këto qëllime arrihen përmes debateve në institucionet e KE-së, përmes aderimit të sa më shumë shteteve evropiane në KE dhe përkushtimit të shteteve anëtare për përparim dhe zhvillim të të drejtave politike, sociale dhe ligjore. Këshilli i Evropës nuk ka ndonjë lidhje institucionale apo ligjore me Bashkimin Evropian, mirëpo çdo shtet anëtar i BE-së para se të anëtarësohej në BE ishte anëtar i KE-së. Selia e institucioneve të KE-së ndodhet në Strasburg të Francës. KE vepron përmes institucioneve të saj, të cilat janë: Asambleja Parlamentare e KE-së, Këshilli i Ministrave, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Sekretari i Përgjithshëm dhe Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale. Gjithashtu KE deri më tani ka nxjerr një numër të madh të konventave dhe numri i tyre arrin në mbi 200 konventa apo traktate, të cilat janë pranuar edhe nga shtete jo anëtare të KE-së.

Ky punim ka për qëllim që të qartësojë sa më shumë mënyrën e anëtarësimit të Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës si dhe pengesat që mund të dalin në rrugën drejt anëtarësimit në KE. Ky shkrim gjithashtu do të mundohet të përshkruajë mënyrën e përfaqësimit të Kosovës në institucionet e KE-së në rast se Kosova pranohet në këtë organizëm ndërkombëtar dhe në fund do të japë rekomandimet rreth hapave që duhet të ndjekë Kosova për t'u anëtarësuar në KE.

KOSOVA DHE KËSHILLI I EVROPËS

Kosova ka deklaruar pavarësinë më 17 shkurt 2008 dhe që nga shpallja e pavarësisë Republikën e Kosovës e kanë pranuar 36 vende të ndryshme të botës, ku 27 nga këto vende janë shtete anëtare të KE-së. Kosova është shtet evropian, shtet ligjor dhe me respekt për të demokracinë parlamentare dhe të drejtat e njeriut – këto janë kushtet e përgjithshme politike të cilat Kosova i ka proklamuar shumë herë, si në Deklaratën e

¹² Belgjika, Danimarka, Franca, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Suedia, Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda Veriore.

¹³ Përveç vendeve anëtare, në KE ekziston edhe statusi i shteteve vëzhguese të cilat janë: Selia e Shenjtë, SHBA, Kanadaja, Japonia dhe Meksiko. Bjellorusia ka aplikuar për anëtarësim mirëpo I është dhënë vetëm statusi i mysafirit special, status I cili është suspenduar pas zhvillimeve të fundit jo demokratike në këtë vend.

Pavarësisë me të cilën Republika e Kosovës zotohet se do t'i respektojë të drejtat e njeriut konform Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, po ashtu edhe përmes Planit të Ahtisarit, plan të cilin e ka pranuar Kuvendi i Kosovës. Rrjedhimisht nga zotimet dhe përkushtimet për këto kritere, si dhe shkalla e përmbushjes së tyre, mund të konkludohet se Kosova plotëson kushtet për të qenë shtet anëtar i KE-së.

Edhe pse Kosova nuk është shtet anëtar i KE-së, Kosova zbaton disa nga Konventat e KE-së. Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme ("Korniza Kushtetuese"), kreu 3, normon aplikimin e disa dokumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ndër të cilat edhe këto konventa të Këshillit të Evropës: Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut dhe protokollet e saj¹⁴, Kornizën e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare, Kartën Evropiane të Gjuhëve Rajonale dhe Minoritare. Këto konventa aplikohen direkt në Kosovë pa asnjë ndërhyrje ligjore nga legjislacioni vendor.¹⁵ Gjithashtu, shumë ligje të Kuvendit të Kosovës dhe rregullore të UNMIK-ut, në preambulat e tyre, i referohen konventave specifike të Këshillit të Evropës, siç është për shembull Konventa evropiane për vetëqeverisje lokale. Edhe me Draft Kushtetutën e Republikës së Kosovës parashihet që Konventat Evropiane të cilat zbatoheshin përmes Kornizës Kushtetuese të zbatohen edhe përmes Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive themelore të Njeriut është konventa më e njohur e KE-së, e cila bazohet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut të OKB-së. Të gjitha shtetet anëtare të KE-së e kanë pranuar këtë Konventë, si dhe disa shtete jo anëtare të KE-së. Edhe pse nuk është rregull e shkruar, shtete aspiruese për t'u anëtarësuar në KE duhet që të pranojnë këtë Konventë. Pranimi deklarativ apo në letër i kësaj Konvente nuk është kushti themelor për t'u anëtarësuar në KE, mirëpo nevojiten edhe rezultate konkrete në respektimin e Konventës.¹⁶ Kosovës do t'i kërkohet që të nënshkruajë edhe konventa tjera të KE-së, e sidomos pas 11 shtatorit 2001, ku KE kërkon me ngulm nënshkrimin e Konventës Evropiane kundër terrorizmit, si dhe Konventën Evropiane kundër krimeve kibernetike.¹⁷

¹⁴ Në kohën e nënshkrimit të Kornizës Kushtetuese nga PSSP më 15 maj 2001 ishin në fuqi 11 protokolle të KE, të cilat nxirreshin me qëllim të plotësimit dhe amendamentimit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kurse tani ekzistojnë 14 protokolle. Korniza Kushtetuese lë hapur çështjen e protokolleve që do të thotë se në Kosovë aplikohen të gjitha protokollat të cilat i nxjerr KE, edhe pas hyrjes në fuqi të Kornizës Kushtetuese.

¹⁵ Në praktikën e të Drejtës Kushtetuese njihen dy mënyra të aplikimit të dokumenteve ndërkombëtare në territorin e një vendi: aplikimi i drejtpërdrejtë pa ndërhyrje me dispozita të legjislacionit vendor, dhe aplikimi i tërthortë apo përmes legjislacionit vendor. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ofron mundësinë që shtetet të mos aplikojnë disa dispozita të Konventës apo edhe t'i aplikojnë këto të drejta duke ndërhyrë përmes legjislacionit vendor.

¹⁶ Edhe pse kishin nënshkruar Konventën për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut, Greqia dhe Turqia ishin suspenduar nga pjesëmarrja në punimet e KE për shkak të shkeljeve të shumta ndaj të drejtave dhe lirive të njeriut, mirëpo me përmirësim të gjendjes këto shtete u lejuan përsëri që t'i bashkohen KE. Mirëpo KE ndjek edhe standarde të dyfishta, marrim shembull Asambleja Parlamentare e KE në vitin 2000 kishte rekomanduar që Rusia të mos ketë të drejtë vote në KE, për arsye të shkeljeve sistematike të të drejtave të njeriut sidomos në krahinën e Çeçenisë, mirëpo pas kërcënimeve nga ana e Rusisë se nëse merret ky vendim Rusia do të tërhiqet plotësisht nga KE, ky organ mbylli sytë dhe lejoi Rusinë të vazhdonte të merrte pjesë në vendimmarrje në kuadër të KE.

¹⁷ Një Konventë tjetër e rëndësishme e KE është edhe Konventa për asistencë të dyanshme në çështjet penale, nga e cila do të mund të përfitonte gjyqësori i Kosovës.

PËRFITIMET QË DO TË KETË KOSOVA NGA ANËTARËSIMI NË KE

KE u themelua me qëllim që t'u jepej fund armiqësive në mes të shteteve në truallin e Evropës, pas dy luftërave të tmerrshme botërore në shekullin XX, të cilat lanë shkatërrime të mëdha dhe ngritën mosbesimet në mes kombeve. Synimi kryesor i KE-së ishte mbrojtja e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe promovimi i demokracisë parlamentare, ku për këtë qëllim krijoi institucionet e saj gjyqësore dhe politike të cilat vlenin për shtete anëtare të KE-së dhe i bëhej presion shteteve anëtare jashtë KE-së. Me zgjerimin gjithnjë e më të madh të Bashkimit Evropian, rëndësia e KE-së po zbehet gjithnjë e më shumë. Kjo ngase BE ofron të gjitha kushtet që i ofron KE, madje i avancon ato në shkallë shumë më të lartë. Të gjitha shtetet anëtare të BE-së kanë qenë fillimisht shtete anëtare të KE, mirëpo anëtarësimi në KE nuk do të thotë që ai shtet është afër anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Shumë shtete anëtare të KE-së janë ende larg anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Mirëpo anëtarësimi në KE ka përparësitë e tij, siç janë konfirmimi i sovranitetit të një vendi, qasja në debatet parlamentare në Asamblesë e KE-së dhe në Këshillin e Ministrave, si dhe qasja në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Përfitimet e anëtarësimit në KE janë më shumë politike, sesa që janë ekonomike, ligjore apo sociale. Anëtarësimi i Kosovës në KE rrit mundësinë që Kosova të mbrojë qytetarët e saj të cilët kanë probleme të natyrave të ndryshme në vendet jashtë Kosovës e që janë anëtare të KE-së. Gjithashtu shtetasit e Kosovës do të mund t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut nëse konsiderojnë se i janë shkelur të drejtat dhe liritë e tyre nga shteti i Kosovës, apo cilido shtet anëtar i KE-së. Mirëpo kjo mund të arrihet vetëm kur të jenë shterur të gjitha mundësitë ligjore kombëtare, tek atëherë qytetarët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.¹⁸

Gjithashtu pjesëmarrja e përfaqësuesve kosovarë në kuadër të KE-së do të rriste prestigjin ndërkombëtar të shtetit të Kosovës dhe do të mund të ndikojë që opinionet e Asamblesë Parlamentare dhe Këshillit të Ministrave të KE-së të jenë më të favorshme për Kosovën.¹⁹

PROCEDURAT PËR ANËTARËSIM NË KE

Duke marrë parasysh përfitimet që mund të ketë Kosova nga anëtarësimi në KE, po ashtu duke marrë në konsideratë kushtet që plotëson Kosova për të qenë anëtare e KE-së, si dhe fakti që një numër i arsyeshëm i konventave të KE-së aplikohen në forma të ndryshme në Kosovë, Kosova duhet që sa më parë të shqyrtojë mundësinë e

¹⁸ Në periudhën tranzitore që nga viti 1999, qytetarët e Kosovës kanë pësuar shkelje të shumta të të drejtave të njeriut si nga IPVQ-të, gjithashtu edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Ngritja e padisë pranë Gjykatës Evropiane të Drejtësisë ka qenë e pamundur për arsye se Kosova nuk ka qenë anëtare e KE.

¹⁹ Në janar të këtij viti, opinioni i Asamblesë Parlamentare të KE ishte që negociatat në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të vazhdojnë deri në gjetjen e një zgjidhjeje të pranueshme për të dyja palët. Mbledhja e ardhshme e Asamblesë së KE pritet të mbahet në këtë muaj dhe edhe pse çështja e Kosovës nuk është në agjendë, pritet që të debatohet për situatën e re të krijuar pas 17 shkurtit, andaj ky debat do të tregojë disponimin e Asamblesë së KE për realitetin e ri në Kosovë si dhe pranimin e Kosovës në KE.

anëtarësimin në KE. Rregullat statutores të KE-së nuk parashohin hapa konkretë rreth procedurave të pranimit të shteteve të reja anëtare në KE. Hapat konkretë të anëtarësimin të shteteve të reja nuk mund të gjenden as në dokumentet bazë të KE-së, siç janë: Statuti i KE-së, Rregullat e punës së Këshillit të Ministrave, Rregullat e Punës së zëvendësve në Këshillin e Ministrave, si dhe Rregullat e punës së Asamblesë Parlamentare të KE-së.

Statuti i KE-së njih dy organe kryesore të KE-së: Këshillin e Ministrave dhe Asamblesë Parlamentare (Konsultative), që mbështetet nga zyra e Sekretarit Gjeneral.²⁰ Organ vendimmarrës është Këshilli i Ministrave të Jashtëm, kurse Asambleja Parlamentare është organ deliberativ, i cili vendimet e tij i komunikon në formë të opinioneve apo rekomandimeve. Këshilli i Ministrave mbledhet dy herë në vit, kurse Asambleja Parlamentare punimet e saj të rregullta i mban një herë në vit dhe ato vazhdojnë për disa muaj.²¹ Këshilli i Ministrave mbledhet zakonisht para seancës së rregullt të Asamblesë Parlamentare dhe pas seancës së Asamblesë Parlamentare.²² Këshilli i Ministrave mban edhe takime të tjera, mirëpo këto takime mbahen nga zëvendësit e Ministrave të Jashtëm, e që njëherësh janë edhe ambasadorë të përhershëm në KE.

Sa i përket pranimit të shteteve të reja anëtare në KE, neni 3 i Statutit të KE-së thotë se çdo shtet evropian duhet t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe parimet e shtetit ligjor. Çdo shtet evropian i cili plotëson parimet e nenit 3 të statutit të KE-së, mund të ftohet që t'i bashkohet KE-së.²³ Rregullorja e punës e Këshillit të Ministrave, respektivisht neni 25, thuhet se për t'u marr në konsideratë anëtarësimi i një shteti të ri në KE, iniciativa duhet të vjen nga një shtet anëtar i KE-së dhe propozimi për këtë duhet të futet me kohë në agjendë për mbledhjen e ardhshme të Këshillit të Ministrave të Jashtëm. Me rastin e marrjes në shqyrtim për pranim të një shteti të ri në KE, para marrjes së vendimit, Këshilli i Ministrave i kërkon opinion apo rekomandim Asamblesë Parlamentare.²⁴ Para se të jap mendimin e saj, Asambleja Parlamentare formon një komision i cili mbikëqyr nga afër përputhjen e legjislacionit vendor me parimet ligjore të KE-së.²⁵ Komisioni i caktuar nga Asambleja për të mbikëqyrur për nga afër situatën në Kosovë paraqet një raport para Asamblesë dhe në bazë të tij Asambleja me 2/3 e votave të anëtarëve merr vendim për apo kundër anëtarësimin të Kosovës në KE.²⁶ Opinioni apo rekomandimi i Asamblesë për Këshillin e Ministrave ka rëndësi vendimtare, ngase edhe pse ky është një institucion konsultativ, mendimi i Asamblesë Parlamentare ka qenë vendimtar me rastin e pranimit apo refuzimit të një shteti të ri në KE. Në rast se rekomandimi i Asamblesë Parlamentare është pozitiv, atëherë Këshilli i Ministrave me 2/3 e votave vendos që t'i bëjë ftesë Kosovës për anëtarësim.²⁷ Këshilli i Ministrave, përmes Sekretarit të Përgjithshëm, i dërgon ftesën për anëtarësim shtetit të ri dhe në ftesë përcaktohet edhe

²⁰ Neni 10 i Statutit të KE.

²¹ Neni 32 i Statutit të KE.

²² Neni 21 i Statutit të KE.

²³ Neni 4 i Statutit të KE.

²⁴ Rezoluta e këshillit të Ministrave e miratuar në mbledhjen e 8 të këshillit në maj 1951.

²⁵ Bazuar në Rezolutën 1115 (1997) e Asamblesë Parlamentare mbi krijimin e komisioneve verifikuese. Gjithashtu komisionet mbikëqyrëse ekzistojnë edhe pas anëtarësimin të vendit në KE dhe varësisht nga shkalla e respektimit të të drejtave të njeriut, komisioni mund të propozoj edhe largimin e vendit ka anëtarësia e KE.

²⁶ Neni 29 i Statutit të KE dhe rregulla 40 e Rregullores së punës së Asamblesë Parlamentare.

²⁷ Neni 20.c i Statutit të KE.

numri i delegatëve që do të përfaqësohen në Asamblenë Parlamentare, si dhe shuma e caktuar e kontributit financiar vjetor në buxhetin e përbashkët të KE-së.²⁸

Mirëpo, anëtarësimi i Kosovës në KE mund të bllokohet nëse çështja e pranimi të Kosovës në KE shqyrtohet në njërin nga takimet e zëvendësve të Ministrave të Jashtëm në kuadër të Këshillit të Ministrave. Sipas Statutit të KE-së dhe Rregullave të punës së Këshillit të Ministrave, çdo anëtar i Këshillit të Ministrave duhet që të caktojë një përfaqësues të përhershëm i cili do të zëvendësojë Ministrin e Jashtëm në takimet jo të rregullta të Këshillit të Ministrave.²⁹ Zëvendësit e Ministrave të Jashtëm kanë kompetenca vendimmarrëse të njëjta me Ministrat e Jashtëm dhe mund të debatojnë të gjitha çështjet të cilat janë në kompetencë edhe të Këshillit të Ministrave në nivel të Ministrave të Jashtëm. Në Rregullat e punës së zëvendësve në Këshillin e Ministrave parashihet edhe vendimmarrja me konsensus për disa çështje me rëndësi, ndër to edhe për vendimin rreth pranimi apo jo të shteteve të reja në KE.³⁰ Mirëpo, vendimi i zëvendësve të Ministrave të Jashtëm për pranim të Kosovës në KE mund të anashkalohet³¹, në rast se çështja e anëtarësimit të Kosovës në KE shqyrtohet në njërin nga mbledhjet e Këshillit të Ministrave në nivel të Ministrave të Jashtëm e jo në nivel të zëvendësve të tyre. Për këtë ftesa duhet të vijë nga brenda, ku në njërin nga mbledhjet e Këshillit të Ministrave të Jashtëm njëri nga shtetet anëtare ngrit çështjen e anëtarësimit të Kosovës në KE. Por prapë se prapë, në proces të shqyrtimit të ftesës për anëtarësim të Kosovës në KE, ekziston mundësia që çështja e Kosovës të diskutohet në kuadër të zëvendësve të Ministrave të Jashtëm, ngase këta mbajnë mbledhje të rregullta javore dhe dyjavore.

PËRFAQËSIMI I KOSOVËS NË BUXHETIN DHE INSTITUCIONET E KE-SË

Si do të dukej anëtarësimi i Kosovës në KE? Në këtë pjesë do të përshkruhet mënyra e përfaqësimit të Kosovës në institucionet e KE-së, si dhe kontributin financiar që Kosova do të paguajë në buxhetin e përbashkët të KE-së.³²

Kontributi i Kosovës në Buxhetin e KE

Shuma financiare që duhet të paguaj çdo shtet anëtar në buxhetin e përbashkët të KE-së llogaritet duke u bazuar në Rezolutën (94)³¹ të Këshillit të Ministrave dhe formula e llogaritjes bazohet në numrin e përgjithshëm të popullsisë dhe në GDP-në kombëtare të tri viteve të fundit. Të dhënat merren nga pasqyrat e Bankës Botërore apo të FMN-së. Shuma minimale e kontributit financiar për çdo shtet është 0.12% e totalit të buxhetit të KE-së. Me 0.12% kontribuojnë Maqedonia, Shqipëria, Mali i Zi, Armenia, Qipro, Estonia, Islanda dhe IRJ e Maqedonisë. Edhe Kosovës mund t'i kërkohet që të kontribuoj me

²⁸ Rregullorja e punës së Këshillit të Ministrave, neni 25 paragrafi i II.

²⁹ Neni 14 i Statutit të KE.

³⁰ Rregulla 9.f. e Rregullave të punës së zëvendësve në Këshillin e Ministrave.

³¹<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1133029&BackColorInternet=9999CC&BackColorIntranet=FFBB55&BackColorLogged=FFAC75> (konsultuar më 2.IV.2008)

³² Ky parashikim është bërë duke krahasuar Kosovën me vendet tjera anëtare të KE, të cilat janë të përafërta për nga numri i popullsisë, territori dhe GDP-ja nacionale.

0.12% të shumës së përgjithshme të buxhetit vjetor të KE-së, që e kthyer në euro për vitin 2008 kjo shumë është 241,199.52€. Shuma financiare në euro mund të ndryshoj nga viti në vit, mirëpo jo edhe përqindja prej 0.12%.³³

Kosova dhe Këshilli i Ministrave i KE-së

Këshilli i Ministrave apo Komiteti i Ministrave ka 47 anëtarë - nga një anëtar nga çdo shtet anëtar në KE. Në Këshillin e Ministrave marrin pjesë Ministrat e Jashtëm të vendeve anëtare. Çdo anëtar në Këshillin e Ministrave ka një votë dhe vota e të gjithëve është e barabartë. Gjithashtu, që nga viti 1951 është vendosur që shtetet të delegojnë një përfaqësues të përhershëm në Strasburg, i cili do të luaj rolin e ambasadorit në KE si dhe në disa raste mund të zëvendësoj Ministrin e Jashtëm të vendit dhe me këtë rast ai ka kompetenca vendimmarrëse. Në këtë institucion Kosova do të përfaqësohet nga Ministri i Jashtëm si dhe nga ambasadori i cili do të caktohet si përfaqësues i përhershëm në KE.

Kosova dhe Asambleja Parlamentare e KE

Asambleja e KE-së është organi më i vjetër parlamentar evropian, si dhe konsiderohet si institucioni parlamentar ndërkombëtar i dyti për nga rëndësia dhe fuqia roli që luan, pas parlamentit Evropian.³⁴ Por edhe përkundër kësaj, Asambleja është një organ konsultativ dhe nuk ka kompetenca vendimmarrëse, përveç në rastet kur vendoset për pranimin e anëtarëve të rinj. Momentalisht Asambleja e KE-së ka 636 anëtarë, ku 318 janë përfaqësues kurse 318 të tjerë janë zëvendës. Për dallim nga Këshilli i Ministrave ku çdo anëtar ka një votë, në Asamblenë Parlamentare të KE-së çdo vend është i përfaqësuar nga një numër jo i barabartë i përfaqësuesve, ku numri ndryshon nga shteti në shtet, nga 2 (shtetet më të vogla) deri në 18 (shtetet më të mëdha). Mbledhjet e rregullta të Asamblesë janë një herë në vit, zakonisht në fillim të çdo viti dhe punimet zhvillohen në disa pjesë. Gjithashtu Asambleja mund të thërras edhe mbledhje të jashtëzakonshme. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë, si dhe me 2/3 e votave, varësisht nga çështjet për të cilat merren vendimet. Duke marrë parasysh përfaqësimin e gjertanishëm të vendeve të ndryshme në Asamblenë Parlamentare të KE-së, mund të supozojmë se Kosova do të përfaqësohet me 2 ose 3 deputet në asamblenë e KE-së, si dhe me 2 apo 3 zëvendës të tyre.³⁵ Njëri nga ta duhet të jetë femër ngase rregulli kërkon që përbërja e delegacionit të përfaqësoj edhe përbërjen gjinore në kuadër të parlamentit kombëtar. Deputetët zgjidhen zakonisht për një seancë të rregullt, që i bie për një vit të plotë dhe ata duhet të zgjidhen nga përbërja e Kuvendit të Kosovës apo të zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës, e që nënkupton se mund të jenë edhe jo anëtarë të Kuvendit të Kosovës. Lista me përfaqësuesit e zgjedhur duhet t'i dërgohet Asamblesë para se të filloj seanca e rregullt vjetore. Njëri nga përfaqësuesit duhet që të caktohet edhe si kryetar i grupit të deputetëve nga Kosova.

³³ Rezoluta (94)31 e Këshillit të Ministrave të KE mbi metodën e kalkulimit të shkallës së kontributeve që shtetet anëtare në buxhetin e KE, miratuar nga Këshilli i Ministrave më 4 nëntor 1994.

³⁴ Zlatko Šabić. Building democratic and responsible global governance: The role of International Parliamentary Institutions. Parliamentary Affairs, Vol.61, Nr.2, 2008. Fq.262.

³⁵ Shqipëria ka 4 përfaqësues dhe 4 zëvendës, kurse Mali i Zi ka 3 përfaqësues dhe tre zëvendës.

Kosova dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Me pranimin eventual të Kosovës në KE, Kosova ka të drejtë që të përfaqësohet me një anëtar në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Zgjedhjen e gjyqtarit në këtë institucion e bën asambleja e KE-së pasi që të ketë pranuar tri propozime nga shteti aplikues. Qeveria e Kosovës duhet të themelojë një komision ad-hoc i cili përmes një konkursi publik do të bënte përzgjedhjen e tre gjyqtarëve, ku njëri nga ta do të zgjidhej si përfaqësues i Kosovës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.³⁶

Kongresi i autoriteteve lokale dhe rajonale

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Regjionale ("Kongresi") është organ konsultativ i KE-së dhe punimet i zhvillon në dy dhoma: Dhoma e Autoriteteve Lokale dhe Dhoma e Autoriteteve Regjionale. Puna e "Kongresit" bazohet kryesisht në Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale dhe është organ i cili lobon për zhvillimin e demokracisë në nivel lokal dhe regjional si dhe ngritjen e kapaciteteve të këtyre autoriteteve. Ndiurma praktike e "Kongresit" jepet në forma të ndryshme përmes disa organizatave si dhe përmes rregullave ligjore.³⁷ Përfaqësimi i Kosovës në "Kongres" do të jetë i barabartë me numrin e përfaqësimit në Asamble, ku në Dhomën e Autoriteteve Lokale do të marrin pjesë dy apo tre kryetarë të komunave të Kosovës³⁸ dhe në Dhomën e autoriteteve Regjionale po ashtu do të marrin pjesë dy apo tre përfaqësues, mirëpo nuk mund të thuhet se si mund të shkojë përfaqësimi në këtë organ, kur dihet se sipas organizmit territorial në Kosovë, Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45 mbi vetëqeverisjen e komunave në Kosovë nuk parashihet njësi regjionale në territorin e Kosovës, por vetëm komunat.³⁹

Institucione të tjera të KE-së janë edhe Sekretariati i Përgjithshëm, Komisionari Evropian për të Drejtat e Njeriut, si dhe Fondacioni i të rinjve të Evropës, institucione të cilat konsiderohen si institucione të pavarura dhe të pa ndikueshme nga interesat e shteteve nacionale.

³⁶ Mali i Zi është shteti më i ri i pranuar në KE. Për zgjedhjen e gjyqtarit në këtë institucion, Mali i Zi ka shpallur konkurs ku ka kërkuar që të aplikojnë për këtë post gjykatës të cilët kanë 15 vite përvojë punë si dhe të njohin së paku njëri nga gjuhët punuese të KE. Përzgjedhjen e kandidatëve ishte bërë nga një komision ad hoc i themeluar me një vendim të qeverisë së Malit të Zi. Pas përzgjedhjes së tre kandidatëve nga ana e këtij komisioni, emrat e tyre së bashku me rezymetë i ishin dërguar Drejtorit Gjeneral për të Drejtat e Njeriut dhe Çështje Ligjore. Listën me emra e dorëzon ambasadori i përhershëm pranë KE. Kjo listë me emrat e tre anëtarëve dhe rezymetë e tyre i është dërguar për aprovim Asamblesë së KE dhe pritet që të merret vendimi në njëri nga mbledhjet e ardhshme të Asamblesë Parlamentare të KE.

³⁷ Ndiurmesat për autoritetet lokale dhe rajonale jepet përmes projekteve si: Rrjeti Evropian i Organizatave të Trajnimit për Autoritetet Lokale dhe Rajonale (ENTO), Agjencitë e Demokracisë Lokale (LDA), etj.

³⁸ Njëri nga kryetarët e komunave me siguri do të kërkohet që të jetë nga komuniteti serb apo përfaqësues i komunës me shumicë serbe. Mali i Zi është i përfaqësuar nga tre kryetar të komunave ku njëri nga ta është shqiptar (Gëzim Hajdinaga – Kryetar i komunës së Ulqinit). Kurse Maqedonia është e përfaqësuar me tre përfaqësues shqiptarë (nga gjashtë gjithsejtë) në "Kongres". Serbia përfaqësohet nga gjashtë kryetarë të komunave të ndryshme, si dhe gjashtë përfaqësues të regjioneve, siç janë Vojvodina, Kragujevci, Beogradi dhe Novi Sadi.

³⁹ Shqipëri në Dhomën e Autoriteteve Lokale është e përfaqësuar nga kryetarët e komunave të Kavajë, Bradesh, Hore-Vranisht dhe Kuçovë; kurse në kuadër të Dhomës së Autoriteteve Regjionale është e përfaqësuar me kryetarët e bashkësive të Tiranës, Durrësit, Elbasanit dhe Fierit.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Kosova i plotëson kushtet për të qenë shtet anëtar i KE-së dhe institucionet e Kosovës duhet të fillojnë përgatitjet për anëtarësim duke ndjekur hapat e përshkruar më lartë. Procedurat për praninë të shteteve të reja janë komplekse dhe të në disa raste edhe të paqarta. Që nga ftesa për anëtarësim e deri tek anëtarësimi i plotë i Kosovës në KE mund të kalojë përafërsisht një vit, varësisht nga obligimet që duhet të përmbush Kosova.

Ekonomikisht, anëtarësimi i Kosovës në KE do t'i kushtoj buxhetit të Kosovës, kurse financiarisht Kosova nuk do të përfitojë nga anëtarësimi i saj në KE. Juridikisht gjyqësori Kosovar do të përfitojë nga anëtarësimi në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu si dhe qytetarët e Republikës së Kosovës. Përfaqësimi i Kosovës në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale do të rrisë efikasitetin e qeverisjes komunale dhe do të përfitojë ndihmë profesionale dhe me trajnime përmes programeve që ofron "Kongresi". Pjesëmarrja e Kosovës në Asambleenë Parlamentare të KE-së do të mundësonte integrimin e Kuvendit të Kosovës për herë të parë në një institucion ndërkombëtar parlamentar dhe kjo do të jetë një përvojë e mirë rreth integritit të Kuvendit të Kosovës në të ardhmen edhe në institucionet tjera parlamentare, siç janë Unioni Ndër-Parlamentar dhe Parlamenti i Evropës (BE).

Debati i organizuar nga Komisioni parlamentar për Integritime Evropiane është hapi i parë që po ndërmerret në këtë drejtim, andaj përfundimet dhe rekomandimet e nxjerra nga ky dëgjim publik duhet të parashtrohen edhe në njërin nga seancat plenare të Kuvendit të Kosovës.

Instituti GAP, përmes Komisionit parlamentar për Integritime Evropiane, rekomandon që:

- Kuvendi i Kosovës të debatojë sa më parë lidhur me anëtarësimin e Kosovës në KE;
- Kuvendi i Kosovës të zotohet se do të zbatojë të gjitha konventat relevante të KE-së;
- Kuvendi të autorizojë qeverinë që kjo e fundit të ndërmerr hapa konkretë lidhur me çështjen e anëtarësimin në KE-së dhe të llojë tek vendet anëtare të KE-së të cilat ende nuk e kanë njohur Republikën e Kosovës;
- Qeveria e Kosovës të themelojë sa më parë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të krijohet një grup ndërinstitucional për praninë e Kosovës në KE;
- Të kërkohet ndihma e një shteti anëtar të KE-së përmes së cilit Kosova do të ftohej për anëtarësim në KE;
- Kuvendi të miratojë rregullat rreth përzgjedhjes së përfaqësuesve të Kosovës në kuadër të institucioneve të KE-së.

FJALORTH TERMASH TË PËRDORURA NË KËTË SHKRIM

Këshilli i Evropës – është organizatë ndërkombëtare e shteteve të Evropës e cila u themelua më 5.5.1949 dhe tani ka 47 shtete anëtare. Qëllimi i Këshillit të Evropës është avancoj mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor, demokracinë parlamentare dhe zhvillim të rajoneve lokale brenda shteteve. Këshilli i Evropës dallon nga Unioni Evropian, këto dyja janë organizata të ndryshme evropiane. Këshilli i Evropës gjithashtu dallon nga Këshilli Evropian. Këshilli Evropian (European Council) është institucion i Unionit Evropian dhe përbëhet nga shefat e shteteve anëtare të UE; kurse Këshilli i Evropës (Council of Europe) është organizatë ndërkombëtare më e gjerë se sa Këshilli Evropian.

Zëvendësit e Ministrave të Jashtëm – janë përfaqësues të përhershëm në Strasburg në nivel të ambasadorëve të cilët zëvendësojnë Ministrat e Jashtëm në kuadër të takimeve të Këshillit të Ministrave. Zëvendësit e Ministrave të jashtëm kanë kompetencë të debatojnë të gjitha çështjet të cilat bien në fushë-veprimtarinë e Këshillit të Ministrave në nivel të Ministrave të Jashtëm, dhe gjithashtu mund të marrin vendim të plotfuqishëm.

Këshilli i Ministrave – është organi vendimmarrës i KE i cili përbëhet nga Ministrat e Jashtëm të të gjitha vendeve anëtare apo nga përfaqësuesit e përhershëm diplomatike që kane këto shtete në Strasburg. Këshilli i ministrave është gjithashtu organ qeverisës ku në mënyrë të barabartë dhe në mënyrë kolektive mund të diskutohet për probleme të ndryshme që ballafaqojnë shoqërinë Evropiane dhe të formulohen zgjidhje të ndryshme. Këshilli i ministrave, së bashku me asamblenë parlamentare, mbrojnë vlerat themelore të KE dhe monitorojnë shtetet anëtare në respekt me përputhshmërinë e tyre në këto marrëveshje.

Asambleja Parlamentare është organ deliberativ i KE i cili merr vendime në formë të opinioneve dhe rekomandimeve. Asambleja Parlamentare mban takimet e rregullta një herë në vit të cilat zgjasin për disa muaj. Asambleja ka 318 përfaqësues të cilët zgjidhen nga parlamentet e shteteve anëtare, si dhe 318 zëvendës të përfaqësuesve të cilët zëvendësojnë përfaqësuesit në rast mungese.

Statuti i KE – është dokumenti bazë i funksionimit të KE i cili fillimisht u nënshkrua në Londër më 5 maj 1949 dhe u amendamentuar disa herë për gjatë viteve.

Rregullat e punës së Asamblesë Parlamentare – është Rregullorja e brendshme e Asamblesë e cila përshkruan mënyrën e votimit, përfaqësimit, përcaktimin e agjendës, zgjedhjen e kryetarit dhe komisioneve, etj.

Rregullat e punës së Këshillit të Ministrave – është Rregullorja e brendshme e Këshillit të Ministrave e cila përcakton çështjet e votimit, kuorumit, mbajtjes së takimeve, etj.

Rregullat e punës së zëvendësve në Këshillin e Ministrave – është Rregullorja e punës së zëvendësve të Ministrave të Jashtëm në kuadër të Këshillit të Ministrave të KE.

Gjykate Evropiane për të Drejtat e Njeriut – është institucion gjyqësor i KE i cili merret me shqyrtimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut në kuadër të shteteve anëtare të KE. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dallon nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë e cila është institucion gjyqësor i Unionit Evropian.

Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale – është institucion parlamentar deliberativ i KE në të cilën marrin pjesë kryetarët e komunave dhe kryetarët e regjioneve. Qëllimi i kongresit është që të rris demokracinë në nivel lokal dhe regional.

Sekretari i Përgjithshëm i KE - është institucion ndihmës i KE i cili mbështet punën e Asamblesë dhe Këshillit të Ministrave. Zgjedhja e Sekretarit të Përgjithshëm dhe zëvendësit të tij bëhet nga Asambleja Parlamentare. Sekretariati ka afro 1800 punonjës të cilët paguhen nga buxheti i përbashkët i KE.

Buxheti i përbashkët i KE nënkupton buxhetin e KE që shërben për të financuar punën e Sekretariatit të KE. Të hyrat në këtë buxhet vijnë nga shtet anëtare duke u bazuar në numrin e popullsisë dhe GDP e përgjithshme të vendit. Përderisa shpenzimet e përfaqësimit në nivel të Asamblesë dhe Këshillit të Ministrave duhet të sigurohen nga çdo shtet për vete.

ANEKSI 3

KOSOVA NË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE (BOTUAR NË MARS 2008)

HYRJE

Kosova ka shpallur pavarësinë me 17 Shkurt 2008, me zotimin se do të zbatojë planin e Ahtisarit. Sipas Planit të Ahtisarit, qeveria e Kosovës është përgjegjëse për marrëdhëniet e jashtme të saj, nga dita kur ky plan hyn në fuqi. Sipas qeverisë së Kosovës, plani i Ahtisarit ka hyrë në fuqi më 17 shkurt 2008. Sipas Rezolutës 1244, Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u) ka përfaqësuar Kosovën në të gjitha forumet dhe marrëveshjet ndërkombëtare deri tani. Në kuadër të autorizimeve që ka, UNMIK-u ka nënshkruar një numër të marrëveshjeve bilaterale dhe multilaterale.

Plani i Ahtisarit po ashtu specifikon periudhën e brendshme transitore 120 ditëshe, periudhë gjatë së cilës përgjegjësitë do të transferohen nga UNMIK-u tek Qeveria e Kosovës. Kjo do të thotë se, më së largu më 16 qershor 2008, autoritetet e Kosovës do të duhej që t'i marrin përsipër përgjegjësitë e marrëveshjeve ndërkombëtare që UNMIK-u i ka nënshkruar në emër të saj. Megjithatë, në javët e fundit që kur u shpallë pavarësia, ka pasur shumë paqartësi ligjore, në lidhje me tranzicionin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP rekomandon që autoritetet e Kosovës gjer në fund të periudhës transitore prej 120 ditësh, të dërgojnë letër tek të gjithë nënshkruarit e këtyre marrëveshjeve dhe t'i njoftojnë se tash e tutje Kosova do t'i marrë përsipër përgjegjësitë e marrëveshjeve të nënshkruara nga UNMIK-u, dhe se që nga ajo ditë, përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, të dalë nga Kushtetuta dhe legjislacioni i aprovuar pas 17 shkurtit 2008 do ta përfaqësojnë Kosovën në këto marrëveshje.

Nëse bashkësia ndërkombëtare beson se ka mundësi të tjera që të qartësohet kjo situatë, ato do të duhej të diskutohen dhe të miratohen sa më parë në mënyrë që t'iu shmangen konfuzioneve të mëtutjeshme.

Qëllimi i kësaj analize është të ngrit çështjet në lidhje me përfaqësimin e Kosovës në marrëveshjet bilaterale dhe ato multilaterale, si dhe iniciativat e nënshkruara nga UNMIK-u në emër të Kosovës. Po ashtu ka për qëllim të informojë palët e interesuara e veçanërisht qeverinë e Kosovës në lidhje me përmbajtjet e këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare, në mënyrë që ata të jenë më të përgatitur dhe të bëjnë plane për t'i përvetësuar përgjegjësitë.

Marrëveshjet

Kosova është nënshkruese e disa marrëveshjeve dhe iniciativave multilaterale dhe bilaterale gjatë viteve të fundit. Shtojca 1 e kësaj analize shkurtimisht shpjegon marrëveshjet multilaterale dhe bilaterale që UNMIK-u i ka nënshkruar në emër të Kosovës.

Pjesëmarrja e Kosovës në këto marrëveshje ndërkombëtare është e rëndësishme për dy arsye. Së pari, Konventa e Montevideos mbi të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Shteteve e cila është pranuar si një deklaratë e saktë e ligjit ndërkombëtar thotë se “shteti si person i ligjit ndërkombëtar duhet të posedojë kualifikimet në vijim: a) popullatë të përhershme; b) territor të definuar; c) qeveri; dhe d) **kapacitetin për të hyrë në marrëdhënie me shtetet e tjera.**”⁴⁰

Së dyti, marrëveshjet bilaterale dhe multilaterale të paraqitura në Shtojcën 1 janë të një rëndësie të veçantë për zhvillimin e Kosovës dhe regjionit. Marrëveshjet si CEFTA, SEETO, dhe Komuniteti i Energjisë në mes tjerash janë shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të Kosovës përmes krijimit të një regjioni të tregtisë së lirë, rrjetit të transportit, si dhe tregut rajonal të energjisë.

Shpallja e Pavarësisë dhe reagimet në Beograd

Deklarata e Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës thekson se “(Kosova) nëpërmjet kësaj merr përsipër obligimet ndërkombëtare të Kosovës, duke përfshirë ato të nënshkruara nga UNMIK-u në emër të Kosovës⁴¹”. Në anën tjetër, Qeveria e Serbisë nuk e pranon shpalljen e pavarësisë, që do të thotë se Serbia me siguri nuk do t’i njoh institucionet e Kosovës duke përfshirë përfaqësimin e këtyre institucioneve në marrëveshjet e nënshkruara nga UNMIK-u para 17 shkurtit 2008. Qeveria e Serbisë vazhdimisht ka kërcënuar se do të bllokojë Kosovën nga të gjitha organizatat ndërkombëtare, duke përfshirë edhe marrëveshjet dhe iniciativat ndërkombëtare. Sekretari i Ministrisë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Dušan Proroković ka deklaruar se Serbia do të rishqyrtojë pozicionin e saj në të gjitha marrëveshjet që ka nënshkruar me UNMIK/Kosovën⁴². Gjithashtu, udhëheqësi i tryezës së parë në Paktin e Stabilitetit për Evropën Juglindore, Goran Svilanović ka thënë se Serbia në marrëveshjet multilaterale me siguri do të pranojnë vetëm përfaqësuesit e UNMIK-ut⁴³.

Plani i Ahtisarit filloi me ...

Pas shpalljes së pavarësisë nga Kosova dhe aprovimi i një misioni të udhëhequr nga BE-ja – EULEX⁴⁴ dhe Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar (PCN)⁴⁵ ekziston një paqartësi

⁴⁰ Konventa e Montevideos është nënshkruar në Konferencën e Shtatë Ndërkombëtare të shteteve Amerikane dhe mund të shihet në <http://www.yale.edu/lawweb/avalon/intdip/interam/intam03.htm>; së fundi është hapur me 27 mars 2008

⁴¹ Deklarata e Pavarësisë së Kosovës.

⁴² Z. Prorokovic theksoi pozicionin e qeverisë mbi marrëveshjen e nënshkruar nga Serbia dhe UNMIK-u/ Kosova në prezantimin e tij “Çfare do të thotë Kosova për Serbinë dhe Ballkanin”, në konferencën “Kosova dhe Pavarësia e Saj”, e mbajtur në Bratislavë, 14 Janar 2008.

⁴³ Në një intervistë të dhënë për B92 (TV Stacionin kombëtar serbë), programi Poligraf, Svilanovici ka theksuar se qeveria Serbe në çdo mbledhje do të kërkojë që Kosovën do të duhej ta përfaqësojë UNMIK-u, edhe pse institucionet e Kosovës do të pretendojnë që të flasin në emër të Kosovës – shiko website-in e B92-shit.

⁴⁴ Misioni i Sundimit të Ligjit të BE-së në Kosovë

⁴⁵ PCN-ja, e emëruar nga Grupi Drejtues Ndërkombëtar (GDN), do të rishikojë implementimin e Planit të Ahtisarit.

lidhur me atë se a ka hyrë në fuqi Propozimi i Ahtisarit dhe kur fillon periudha 120 ditore e tranzicionit siç është i përcaktuar në këtë Propozim. Paqartësitë lidhen më së shumti me UNMIK-un, pasi që Këshilli i Sigurimit i OKB-së nuk e ka aprovuar Propozimin e Ahtisarit, edhe pse Sekretari Përgjithshëm i OKB-së dhe përfaqësuesit e tij në Kosovë publikisht e kanë përkrahur propozimin⁴⁶. Në anën tjetër, Shpallja e Pavarësisë së Kosovës thotë se është në përputhje të plotë me rekomandimet e Propozimit të Ahtisarit, duke bërë që dita e shpalljes së pavarësisë të jetë edhe dita kur hyn në fuqi Plani i Ahtisarit. Grupi Drejtues Ndërkombëtar (GDN) për Kosovën të cilët emëruan PCN-në, kanë deklaruar se PCN-ja do t'i marrë përgjegjësitë e tij të plota pas periudhës së tranzicionit dhe se menjëherë do të fillojë të monitorojë dhe lehtësojë implementimin e Planit të Ahtisarit⁴⁷. Kjo po ashtu nënkupton pranimin nga ana e tyre se Propozimi i Ahtisarit ka hyrë në fuqi.

Nën supozimin se Propozimi i Ahtisarit ka hyrë në fuqi me 17 shkurt 2008, periudha tranzitore 120 ditëshe mbaron me 16 qershor 2008. Propozimi i Ahtisarit thotë se UNMIK-u në bashkëpunim të ngushtë me PCN-në, do të sigurojë tranzicionin e rregullt nga korniza ligjore aktuale në fuqi tek korniza ligjore e krijuar nën këtë plan të Statusit Përfundimtar. Bazuar në këtë, Propozimi i Ahtisarit po ashtu thekson se Kosova do të duhej të obligohej, mbi bazat e reciprocitetit kur është e përshtatshme, me të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare dhe marrëveshjet e tjera në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar që u nënshkruan nga UNMIK-u, për dhe në emër të Kosovës, të cilat ishin aktive në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshje⁴⁸.

Roli i UNMIK-ut

Nën Rezolutën e Këshillit të Sigurimit 1244, UNMIK- u ishte mbrojtësi i vetëm ligjor i Kosovës, gjerë më 17 Shkurt 2008. Si mbrojtës ligjor, UNMIK-u ka përfaqësuar Kosovën në të gjitha zhvillimet ndërkombëtare. UNMIK-u ka qenë pjesëmarrës, negociator dhe ka hyrë në iniciativa dhe marrëveshje bilaterale dhe multilaterale me vendet e tjera në sektorë të ndryshëm.

Megjithatë, Qeveria e Kosovës ka të drejtën që të deklarohet se Kosova nuk duhet të obligohet të aplikojë si anëtare e re, pasi që UNMIK-u e ka nënshkruar marrëveshjen në emër të saj. Sipas Konventës së Vjenës mbi Ndarjen e Shteteve në respekt të Traktateve⁴⁹, Kosova si shtet i ri i pavarur mund, me njoftimin e ndarjes, të krijojë statusin e saj si pjesë e çdo traktati multilateral, e cila në ditën e ndarjes ishte në fuqi. Edhe pse Kosova veç se ka dërguar letra tek te gjitha shtetet që t'i njoftojë ato për shpalljen e pavarësisë dhe ka kërkuar nga ato njohjen e këtij shteti të ri, Qeveria e

⁴⁶ Ban Ki-Moon shumë shpesh ka theksuar mbështetjen e tij të plotë për planin e Ahtisarit, p.sh. në letrën drejtuar Kryetarit të Këshillit të Sigurimit, më 26 Mars 2007, sikurse edhe tek Joachim Rucker, në komunikatën për media të UNMIK-ut 1656, më 26 Mars 2007.

⁴⁷ Shiko Deklaratën për Shtyp të GDN-së, 28 Shkurt 2008, në dispozicion të faqes zyrtare të ZNC-së: www.ico-kos.org.

⁴⁸ Shiko Artikullin 15.2.2. në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (Plani i Ahtisarit)

⁴⁹ Kjo është vetëm njëra nga justifikimet që mund të përdoren për këto marrëveshje multilaterale

Kosovës do të duhej që ndaras të njoftojë shtetet nënshkruese të çdo marrëveshjeje ose traktati që ajo i ka marrë përsipër obligimet dhe detyrat e dala nga këto marrëveshje ose traktate.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Kosova duhet të marrë përsipër përgjegjësitë nga marrëveshjet ndërkombëtare të cilat u nënshkruan nga UNMIK-u në emër të saj, dhe ato të cilat ishin në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Ahtisarit. Edhe pse këto marrëveshje ishin të nënshkruara nga UNMIK-u, institucionet e Qeverisë së Kosovës kanë qenë pjesë e këtyre marrëdhënieve dhe kanë qenë të përfshira në implementimin e tyre në terren.

Përderisa Kosova u deklarua si shtet sovran, është shumë logjike që të kërkojë përfaqësimin e saj të drejtpërdrejtë në marrëveshjet ndërkombëtare të cekura më lartë. Po ashtu pritet që Serbia duke qenë pjesë e këtyre marrëveshjeve të mos pranojë që institucionet e reja të Kosovës të përfaqësohen në këto marrëveshje. Në anën tjetër, UNMIK mund të insistojë në vazhdimësinë e përfaqësimit të tij në këto marrëveshje në interes të Kosovës, meqë ende e konsideron si të vlefshme Rezolutën 1244.

Sa i përket specifikave të çdo marrëveshjeje ndërkombëtare, asnjëra prej këtyre marrëveshjeve nuk parasheh procedurat apo mekanizmat se cilët hapa duhen ndjekur si dhe si të vazhdohet me zbatimin e tyre në rast të ndarjes së shteteve. Përderisa asnjëra prej marrëveshjeve nuk ofron procedura apo mekanizma në rast të ndarjes së shteteve, Kosova ka për bazë mundësinë e njoftimit të ndarjes së saj në përputhshmëri me çdo marrëveshje (traktat), në pajtim me Konventën e Vjenës mbi Ndarjen e Shteteve në respekt të Traktateve. Shpallja e ndarjes në lidhje me çdo traktat apo marrëveshje mund të nxisë reagime kundërshtuese nga UNMIK-u, Serbia, apo edhe nga disa shtete tjera si pjesë e këtyre marrëveshjeve që nuk e kanë bërë njohjen e Kosovës si shtet. Megjithatë, kjo çështje do të duhej të diskutohet herët apo vonë. Prandaj, është e nevojshme për Qeverinë e Kosovës të vlerësojë rëndësinë e secilës marrëveshje ndërkombëtare si dhe marrëdhëniet e saj të jashtme, të tanishme dhe ato të ardhshme, me çdo shtet nënshkrues të këtyre marrëveshjeve, përpara se të vendos të marrë masa në lidhje me përfaqësimin e saj të drejtpërdrejtë në këto marrëveshje.

Instituti për hulumtime të avancuara GAP rekomandon që autoritetet kosovare si dhe komuniteti ndërkombëtarë t'i koordinojnë përpjekjet e tyre në këtë drejtim sa më shpejt që të jetë e mundur. Kjo çështje do të jetë më relevante në qershor, por qëllimet dhe planet duhet të jenë të qarta që tani.

Autoritetet kosovare duhet që:

- Të bëjnë të gjitha përgatitjet e duhura për të marrë përgjegjësitë nga marrëveshjet ndërkombëtare para përfundimit të periudhës transitore prej 120 ditësh, siç është paraparë në planin e Ahtisarit.

- Para përfundimit të periudhës 120 ditëshe, të lajmërojnë të gjithë nënshkruesit e këtyre marrëveshjeve ndërkombëtare se i pranojnë këto përgjegjësi, duke përfshirë këtu përfaqësimin nga autoritetet e Kosovës në takimet e këtyre forumeve. Institucionet e Kosovës duhet të fillojnë me marrëveshjet ku nuk priten vështirësi në transferimin e përgjegjësi nga UNMIK-u.

Nëse autoritetet kosovare dhe komuniteti ndërkombëtar mund të pajtohen për ndonjë mundësi tjetër i cili nuk e rrezikon deklaratën e pavarësisë dhe sovranitetin e Kosovës, të pranuar nga shumë shtete rreth botës, këto mundësi duhet të diskutohen, të pajtohen dhe të bëhen publike sa më shpejt që të jetë e mundur, për të mënjanuar paqartësi të mëtejshme mbi bazat ligjore të misionëve të ndryshme në Kosovë.

MARRËVESHJET BILATERALE DHE MULTILATERALE

MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

UNMIK-u ka nënshkruar dhe ka marrë pjesë në iniciativa të ndryshme multilaterale ndërkombëtare dhe në marrëveshjet në emër të Kosovës. Edhe pse UNMIK-u ligjërisht nënshkroi këto marrëveshje në emër të Kosovës, institucionet përkatëse në Qeverinë e Kosovës janë institucionet që faktikisht zbatojnë këto marrëveshje. Tabela 1 tregon listën e marrëveshjeve multilaterale ndërkombëtare ku Kosova është anëtare, si dhe institucionet përkatëse të Kosovës.

Tabela 1 Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe Iniciativat të nënshkruara nga UNMIK në emër të Kosovës

Marrëveshja/Iniciativa	Shkurtesa	Institucionet Përgjegjëse
Komuniteti i Energjisë (Procesi i Athinës)	EC	Ministria e Energjisë dhe Minierave
Marrëveshja Europiane e Hapësirave të Përbashkëta të Aviacionit	ECAA	Ministria e Transportit dhe Komunikacionit
Observatori i Transportit në Europën Juglindore	SEETO	Ministria e Transportit dhe Komunikacionit
Marrëveshja e Tregtisë së Lirë se Europës Qendrore	CEFTA	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Karta Europiane për Ndërmarrje të Vogla	ECSE	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Pakti i Stabilitetit	SP	Koordinatori i Paktit të Stabilitetit
Iniciativa Elektronike e Europës Juglindore	eSEE	Ministria e Transportit dhe Komunikacionit
Iniciativa Broadband e Europës Juglindore	bSEE	Ministria e Transportit dhe Komunikacionit
Iniciativa për Largimin e Barrierave Jo-Tarifore	N/A	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Komuniteti i Energjisë (Procesi i Athinës)⁵⁰

E nënshkruar më 2005 në Athinë, Marrëveshja e Komunitetit të Energjisë është rezultat i një procesi të filluar më 2002 kur Komisioni Evropian propozoi zyrtarisht strategjinë për

⁵⁰ Informata mbi Komunitetin e Energjisë është marrë nga website-i në vijim:
www.energy-community.org; www.seecon.org/infrastructure/sectors/energy/index.html;
<http://www.stabilitypact.org/energy/default.asp>.

zhvillimin e një tregu për energjinë rajonale të Evropës Juglindore (EJL). Shtetet e Evropës Juglindore janë pajtuar në implementimin e legjislacionit të Bashkimit Evropian dhe krijimin e infrastrukturës së domosdoshme për të operuar në këtë treg të përbashkët. Anëtarët e marrëveshjes janë Bashkimi Evropian, në një anë, dhe Shqipëria, Bullgaria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Romania, Serbia dhe UNMIK në interes të Kosovës, në anën tjetër. Shtetet nënshkruese të Evropës Juglindore e shohin këtë proces si formë për të siguruar një furnizim të sigurt të energjisë, ndërsa stimulohet zhvillimi ekonomik në rajon, përmes një rritjeje të arsyeshme të çmimit, efikasitetit dhe varësisë së rrjeteve të tyre energjetike. Me zhvillimin e integritit rajonal në sektorin energjetik, shtetet e EJL-së shprejnë të krijojnë më shumë rivalitet dhe tregti në rajon, eventualisht duke rezultuar në më shumë integrim ekonomik me Bashkimin Evropian. Në dhjetor 2005, Këshilli i Ministrave i Komunitetit të Energjisë miratoi projektin strategjik për bartje të energjisë, pas konsultimit me aksionarët e Procesit të Athinës. Përmes zbatimit të kësaj marrëveshjeje, të gjitha palët ishin në gjendje të pajtohen mbi sfidat e përgjithshme dhe zgjidhjet e mundshme që do të mund t'i zbatojnë bashkërisht.

Për sa i përket vlefshmërisë së kësaj marrëveshjeje tashmë kur Kosova deklaroi pavarësinë, nuk duket të jetë përfshirë ndonjë mekanizëm apo procedurë në vetë marrëveshjen në lidhje me ndryshimin e statusit të të nënshkruarit. Megjithatë, ky traktat thekson se Këshilli i Ministrave të Komunitetit Energjetik mund të pajtohet në shtimin e një anëtari të ri vetëm “me votë unanime të anëtarëve të saj”, edhe pse kjo nuk vlen në rastin e Kosovës, pasi që Kosova pothuajse është pjesë e kësaj marrëveshjeje përmes UNMIK.

Marrëveshja mbi Hapësirën e Përbashkët Evropiane në Aviacion (ECAA)⁵¹

Me qëllimin e hapjes së tregtisë së transportit ajror në mes të Evropës dhe shteteve përreth, ECAA synon të krijoj një marrëveshjeje për aviacion ndërkombëtarë duke zbatuar standardet dhe rregullat e përgjithshme përgjatë rajonit në fjalë, mundësisht si një zgjerim të iniciativës për Qiellin e Përbashkët Evropian (Single European Sky). Duke ndjekur të njëjtin model si të tregtisë së brendshme të BE-së, ECAA u nënshkrua nga Bashkimi Evropian, në një anë, dhe Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Islanda, IRJ e Maqedonisë, Norvegjia, Serbia, Mali i Zi, Romania dhe UNMIK në interes të Kosovës, në anën tjetër.

Shtetet ballkanike veç se kanë përfituar shumë nga ECAA. Përveç nga rritja e trafikut ajror në mes të BE-së dhe SEE (121% rritje që nga viti 2001), tregu i vetëm për aviacion gjithashtu ka ofruar asistencë teknike, si dhe përkrahje dhe monitorim në trajnime në këtë rajon. Integrimi i plotë në tregun evropian të transportit ajror vetëm që do të rris më shumë zhvillimin e transportit ajror. (2006 ECAA Komunikatë për media).

⁵¹ Për këtë dhe informata të tjera mbi ECAA-në shiko:

http://ec.europa.eu/transport/air_portal/international/pillars/common_aviation_area/ecaa_en.htm.

ECAA nuk ka ndonjë procedurë apo mekanizëm specifik për sa i përket suksesionit të shteteve. Ajo vetëm ofron mundësinë për ndryshime në legjislacion, ku shtetet pjesëmarrëse duhet të njoftohen përmes Komitetit të Bashkuar jo më vonë se një muaj pasi të ketë ndodhur ndryshimi. Serbia, përveç që kundërshton pjesëmarrjen e Kosovës si shtet i ri në marrëveshje pa prezencën e përfaqësuesve të UNMIK, ajo gjithashtu mund të deklarojë Kosovën si “zonë armiqësore”, me mundësi për të rezultuar në rritje të çmimeve të sigurimit të udhëtimit ajror për të gjitha udhëtimet ajrore brenda dhe jashtë Kosovës.

Observatori i Transportit të Evropës Jug-Lindore (SEETO)⁵²

Ky Memorandum i Mirëkuptimit përkrah bashkëpunimin në zhvillimin e infrastrukturës kryesore dhe ndihmëse të Rrjetit Transportues Rajonal të Evropës Juglindore, duke përfshirë politikën gjatë ndërtimit, përdorimit, mirëmbajtjes, rindërtimit, rehabilitimit dhe përmirësimit të saj. Ajo gjithashtu ofron mënyra për harmonizimin dhe standardizimin e dispozitave rregullative dhe administrative, si dhe standardet teknike, që kanë të bëjnë me qarkullimin e transportit rajonal. Me zhvillimin e mjeteve më efikase dhe të përshtatshme për ambientin në nivel rajonal, Observatori është në përputhje të plotë me standardet dhe direktivat e BE-së, duke përfshirë, ku është e mundur, edhe harmonizimin e doganës dhe kontrollit kufitar.

Shtetet nënshkruese të këtij memorandumi janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, dhe UNMIK në interes të Kosovës.

Memorandumi i Mirëkuptimit SEETO gjithashtu nuk ofron ndonjë mekanizëm apo procedurë në lidhje me suksesionin e shteteve apo ndryshim të statutit të një nënshkruesi.

Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë⁵³

Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të lirë (CEFTA) e formuar fillimisht nga Polonia, Hungaria, Republika Çeke dhe Republika Sllovaqe si një përpjekje për t'u anëtarësuar në institucionet Euro-Perëndimore, ka hyrë në fuqi në vitin 1994.

Të motivuar nga ideja për t'u bashkëngjitur përfundimisht sistemit politik, ekonomik, atij të sigurisë dhe sistemit legal të Evropës, këto shtete nënshkruese shpresuan të konsolidojnë demokracinë dhe ekonominë e tregut të lirë në nivelin regjional. Shtetet tjera ndoqën procesin dhe iu bashkëngjitën CEFTA-s pas një periudhe shumë të shkurtër kohore: Sllovenia më 1996, Romania më 1997, Bullgaria më 1998, Kroacia më 2003 dhe Maqedonia më 2006. Që nga fillimi, të gjithë pjesëmarrësit e parë kanë lënë CEFTA-në në favor të integritimit në Bashkimin Evropian. Për këtë arsye dhe për faktin se ekzistonte pothuajse një matricë e kompletuar e marrëveshjeve dypalëshe për tregti të lirë e

⁵² Kjo dhe informata të tjera SEETO-në mund të gjinden në faqen zyrtare të website-it: <http://www.seetoint.org/site/>.

⁵³ Kjo dhe informata të tjera mbi CEFTA-në janë në dispozicion në: <http://www.stabilitypact.org/wt2/TradeCEFTA.asp>.

ndërtuar në Paktin e Stabilitetit të Evropës Jug-Lindore, CEFTA u zgjerua në shtetet tjera të Ballkanit. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Moldavia dhe UNMIK-u në emër të Kosovës u bënë nënshkruese të CEFTA-s në vitin 2006. Hyrja në fuqi e marrëveshjes, në vitin 2007, ka për qëllim krijimin e tregut të lirë në rajon gjer në fund të vitit 2010.

Pasi që njëri nga rekomandimet e Bashkimit Evropian është që shtetet kandidate të krijojnë zona të tregtisë së lirë, dhe duke u bazuar në hyrjen e ish anëtareve të CEFTA-s në Bashkësinë Evropiane, CEFTA paraqitet si një mundësi e shkëlqyeshme për anëtarësim të plotë në BE. Për më tepër, fakti që një përqindje e konsiderueshme e tregtisë së jashtme të CEFTA-s bëhet me një numër të madh të shteteve anëtare të BE-së, shton aspiratat e shteteve të Ballkanit për anëtarësim.

Në statutin e CEFTA-s, apo në amendamentet që kanë pasuar (1995, 2003), nuk ekzistojnë masa për t'u ndjekur me rastin e ndarjes apo ndryshimit të statusit legal të ndonjë shteti anëtar të CEFTA-s apo në amendamentin që ka pasuar. Edhe pse nuk ka nevojë që Kosova të ri-aplikojë, është e rëndësishme të ceket se për një shtet të ri të pranohet në CEFTA, një Marrëveshje e Anëtarësimit duhet të nënshkruhet nga të gjitha shtetet anëtare të CEFTA-s.

Karta Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla⁵⁴

E pranuar së pari nga udhëheqësit e BE-së në vitin 2000, Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Serbia, Mali i Zi dhe UNMIK-u në emër të Kosovës iu bashkuan Kartës në vitin 2003, në Samitin e Selanikut. Pas mbarimit të fazës së parë, BE ka aprovuar kërkesën për ta zgjatur procesin edhe tri vite dhe si rezultat i kësaj u rrit edhe më shumë bashkëpunimi politik dhe ekonomik në mes të BE dhe Ballkanit Perëndimor.

Në mënyrë që të krijohet një ambient miqësor biznesi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, Karta përfshinë dhjetë sfera, përfshirë legjislacion më të mirë dhe hapje më të shpejtë të bizneseve të reja, e cila siguron bashkëpunim të barabartë të shteteve anëtare, fuqizon identitetin regional dhe marrëdhëniet ekonomike, të liruara nga të gjitha influencat politike.

Karta Evropiane për Ndërmarrje të Vogla ka procedurat e aplikimit për shtetet që dëshirojnë të anëtarësohen në Statut, sidoqoftë nuk i cekë procedurat që do të aplikoheshin në rast të ndryshimit të statusit të shtetit, siç është rasti i Kosovës.

Pakti i Stabilitetit⁵⁵

Me qëllim të ushtrimit të paqes, demokracisë, respektit për të drejtat e njeriut dhe prosperitet ekonomik në Evropën Jug-Lindore, Pakti i Stabilitetit, i cili u lansua më

⁵⁴ Kjo dhe informata të tjera mbi Karta Evropiane për Ndërmarrjet e Vogla në janë në dispozicion në: http://ec.europa.eu/enterprise/enterprise_policy/charter/index_en.htm.

⁵⁵ Kjo dhe informata të tjera mbi Paktin e Stabilitetit janë në dispozicion në: <http://www.stabilitypact.org/>.

1999, është zbërthyer në tri Tryeza Punuese: Tryeza 1 merret me demokratizimin dhe të drejtat e njeriut; Tryeza me rindërtim ekonomik, bashkëpunim dhe zhvillim; dhe Tryeza 3 merret me mbrojtje, siguri, drejtësi dhe çështje të brendshme. Partnerët regional në Pakt janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Moldavia, Mali i Zi, Rumania, Serbia, Maqedonia dhe UNMIK-u në emër të Kosovës. Anëtarët e tjerë përfshijnë të gjitha shtetet tjera anëtare të EU-së, Komisionin Evropian, Kanadaja, Japonia, Norvegjia, Rusia, Zvicra, Turqia dhe SHBA, si dhe trupat e tjerë ndërkombëtar si OKB, OSBE, NATO, Banka Botërore dhe FMN, dhe iniciativat si Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Jug-Lindore dhe Iniciativa e Evropës Qendrore, ndër të tjera.

Ashtu siç nxit bashkëpunimin ndërmjet shteteve të EJL, Pakti gjithashtu shton mundësitë integruese të vendeve regionale në aspektin politik, ekonomik dhe të sigurisë. Pakti në vetvete nuk implementon projekte, por në vend të kësaj vepron, përmes iniciativave të ndryshme, si vegël koordinimi dhe përsheptimi të projekteve të partnerëve të saj.

Iniciativa Elektronike e Evropës Jug-Lindore (eSEE)

Në emër të integritimit më të lehtë dhe më të shpejtë të shteteve të Evropës Jug-Lindore në ekonominë globale të bazuar në njohuri (global knowledge-based economy), eSEE-ja mbështet zhvillimin e Shoqërisë Informative (përfshirë krahasimin me praktikën më të mira në transferimin e diturisë) në shtetet në regjion. Në linjë me politikën e BE-së eSEE-ja koordinon dhe ndihmon krijimin e projekteve të Teknologjisë së Informatikës dhe Komunikimit në drejtime si biznes, qeverisje, shëndetësi dhe edukim dhe promovon ambient të përshtatshëm institucional për zhvillimin e Shoqërisë Informative, të arritshme për të gjithë.

Iniciativa e Broadband-it të Evropës Jug-Lindore (bSEE)

Duke ndjekur modelet e ngjashme të iniciativave multilaterale në regjion, bSEE-ja ndihmon bashkëpunimin ndërmjet partnerëve, përfshirë ndarjen e informatave në lidhje me zhvillimin e broadband-it, trendet dhe strategjitë në regjion, si dhe lidhjet e politikave dhe programeve të agjencive dhe organizatave të shteteve anëtare të Evropës Jug-Lindore.

Iniciativa për mënjanimin e barrierave jo-tarifore.

Kosova gjithashtu merr pjesë në Iniciativën për mënjanimin e barrierave tatimore në rrethanat e favorshme të Paktit të Stabilitetit. Kjo iniciativë së shpejti do të integrohet në CEFTA.

Pakti i Stabilitetit për Evropën Jug-Lindore, apo cilado nga iniciativat e saj, nuk parashohin asnjë mekanizëm specifik apo procedurë të brenda dokumenteve të tyre në lidhje me ndryshimin e statusit të shteteve nënshkruesve.

MARRËVESHJET BILATERALE

Shumica e iniciativave bilaterale dhe marrëveshjeve të nënshkruara nga UNMIK-u/ Kosova me shtetet tjera janë me Shqipërinë, Turqinë, SHBA-në dhe organizatat e tjera ndërkombëtare sikurse Banka e Investimeve Evropiane (EIB) dhe Banka Evropiane për Ndërtim dhe Zhvillim (EBRD). Edhe pse statusi momental politik i Kosovës është zgjidhur jashtë proceseve të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Kosova s' do të ketë problem për t'i marr përsipër këto iniciativa dhe marrëveshje nga UNMIK-u, meqenëse të gjitha këto shtete dhe institucione tashmë e kanë njohur Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran.

UNMIK-u po ashtu ka nënshkruar marrëveshje për projekte me donatorë të ndryshëm në emër të Kosovës. Përgjegjësia ligjore duhet të bartet sa më shpejtë për t'ju shmangur vonesave në implementimin e projekteve.

Përveç marrëveshjeve më lartë, ka ende disa iniciativa që kanë qenë të filluara por të papërfunduara, kryesisht me Maqedoninë, gjithashtu edhe me Turqinë, Slloveninë, Bullgarinë dhe Austrinë. Me pranimin e shtetësisë së Kosovës nga Austria, Sllovenia, Turqia, Bullgaria, dhe kur e dimë që Maqedonia është në favor të planit të Ahtisarit, përfundimi dhe miratimi i këtyre iniciativave sipas të gjitha gjasave nuk do të paraqet ndonjë problem serioz.

Tabela 2 Marrëveshjet dhe Iniciativat Bilaterale (të nënshkruara dhe të iniciuara)

Marrëveshjet/Iniciativat	Ministria Përgjegjëse në IPVQ
Marrëveshja Kornizë me Bankën Europiane për Investime	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MiM me EBRD	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
Marrëveshje me Qeverinë e SHBA në mbështetje të Investimeve për Projekte në Kosovë	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Marrëveshje me Shqipërinë për menjanimin e tatimeve të dyfishta	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MiM me Shqipërinë në fushat e Standardizimit dhe Akreditimit	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Marrëveshje me Shqipërinë për bashkëpunim në fushën e turizmit	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Marrëveshje me Shqipërinë në promovimin reciproj dhe mbrojtjen e investimeve	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Marrëveshja me Turqinë në promovimin reciprok dhe mbrojtjen e investimeve	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Marrëveshja dhe MiM i bashkangjitur me Shqipërinë mbi bashkëpunimin në fushën e energjisë	Ministria e Energjisë dhe Minerave
Marrëveshja me Shqipërinë në Bashkëpunimin e Shërbimeve Publike Veterinare	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Zhvillimit Rural
Marrëveshja me Shqipërinë mbi bashkëpunimin për Mbrojtjen e Bimëve	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Zhvillimit Rural
Marrëveshjet/Iniciativat (të iniciuara, por jo të kompletuara)	Ministria Përgjegjëse në IPVQ
MiM me Maqedoninë në fushat e Standardizimit dhe Akreditimit	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Marrëveshja me Maqedoninë për bashkëpunim në fushën e Turizmit	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Marrëveshja me Turqinë për bashkëpunim në fushën e Turizmit	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Marrëveshja me Maqedoninë në promovimin reciprok dhe mbrojtjen e investimeve	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Marrëveshja me Slloveninë në promovimin reciprok dhe mbrojtjen e investimeve	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Marrëveshja me Austrinë në promovimin reciprok dhe mbrojtjen e investimeve	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Marrëveshja me Maqedoninë për bashkëpunim në fushën e Transportit	Ministria e Transportit dhe Komunikacionit
Marrëveshja me Maqedoninë për bashkëpunim të Shërbimeve Publike Veterinare	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Zhvillimit Rural
Marrëveshja me Maqedoninë për bashkëpunim në fushën e Mbrojtjes së Bimëve	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Zhvillimit Rural
MiM me Bullgarinë për bashkëpunim në fushën e energjisë	Ministria e Energjisë dhe Minerave